



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 602 Akti

Nr. 389 Vendimi
Tiranë, më 20.5.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Brunilda Bektashi	Relatore
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në datën 18.5.2021, ora 09:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Migena Laska**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bektashi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Migena Laska, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj).

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të germës “b”, të pikës 7, të nenit 3 dhe pikës 9, të nenit 3, të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, miratuar me vendimin nr. 50, datë 18.10.2019, si dhe me kërkesën nr. *** prot., datë 9.7.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni, në mbledhjen e datës 16.7.2020, organizoi short të veçantë dhe të posaçëm për këtë subjekt, duke vendosur trajtimin e procedurës së rivlerësimit të saj me përparësi, nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Firdes Shuli, Brunilda Bekteshi dhe Suela Zhegu. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.

4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 20.7.2019, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Migena Laska, si dhe caktoi kryesuesen e trupit gjykues, komisioneren Firdes Shuli. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

5. Në datën 22.7.2020, subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, në të njëjtën datë, deklaroi përmes postës elektronike marrjen dijeni për njoftimin dhe trupin gjykues, si dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

6. Në datën 26.4.2021, Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Migena Laska, për të tria kriteret e rivlerësimit: kriterin e pasurisë, kriterin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të paraqesë pretendimet e saj brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 26.4.2021, subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda 10 ditëve. Subjekti konfirmoi marrjen dijeni duke kërkuar në vijim kopje të analizës financiare në formatin *Excel*, e cila iu vu në dispozicion. Brenda afatit të caktuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit dërgoi shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ në mënyrë elektronike dhe zyrtare.

8. Trupi gjykues, në datën 10.5.2021, me vendimin nr. 3 vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Migena Laska, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Në datën 12.5.2021, subjekti u njoftua me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 18.5.2021, në orën 09:30, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë. Deri ditën e seancës, në datat 12, 14 dhe 17 maj 2021, subjekti depozitoi shpjegime dhe prova shtesë mbi rezultatet e hetimit administrativ duke shpjeguar edhe qëllimin e tyre.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Migena Laska u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar Branko Hrvatit. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Migena Laska. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 18.5.2021 për të rifilluar në datën 20.5.2021 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Znj. Migena Laska ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLGJ-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/20176 të Gjykatës Kushtetuese¹ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

Në deklaratën e pasurisë, shtojca 2, dorëzuar në ILDKPKI në datën 25.1.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti ka deklaruar:

1. Automjet tip “Volkswagen Passat”, me targa *, blerë në datën 9.8.2016, bazuar në kontratën noteriale nr. ***, datë 9.8.2016.** Burimi i krijimit të kësaj pasurie: shitja e automjeteve të mëparshme në pronësinë e subjektit, të realizuara edhe këto nga të ardhurat, ndër vite, të krijuara nga paga si gjyqtarë, si dhe nga interesat e përfituara nga bonot e thesarit (ndër vite), të deklaruara periodikisht në ILDKPKI në deklaratat e pasurisë ndër vite. Vlera: 10.000 euro. Pjesa takuese: 100%.

1.1 Për këtë pasuri subjekti ka depozituar² dokumentacioni mbështetës.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

¹Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

²Aneks nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

1.2 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016 me përshkrimin “automjet tip ‘Volkswagen Passat’, me targa ***, i blerë në datën 9.8.2016, bazuar në kontratën noteriale nr. ***, datë 9.8.2016, kryer para noterit publik Sh. Gj. . Vlera: 10.000 euro”. Nuk është deklaruar burimi i krijimit të kësaj pasurie.

1.3 DPSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 12.8.2020, informon se nga verifikimet e bëra në sistemin informatik rezultoi se shtetasja Migena Gj. Laska aktualisht ka të regjistruar në pronësi automjetin me targa *** dhe ka pasur të regjistruara në pronësi të saj automjetet me targa AA *** (***), AA ***, AA *** (AA ***), AA ***, AA ***.

1.3.i Kjo drejtori, përgjigjen e ka shoqëruar edhe me dokumentacionin përkatës për secilin automjet. Automjeti tip “Volkswagen Passat”, me targa ***, konfirmohet me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 9.8.2016, mes palëve, shitës G. F. L. dhe blerëse Migena Gj. Laska. Vlera: 10.000 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

1.3.ii Automjeti është shitur pas dorëzimit të deklaratës *Vetting*, veprim ky që konfirmohet me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 31.7.2018, mes palëve, shitës Migena Gj. Laska dhe blerës Gj.S. . Vlera e shitjes së automjetit: 10.000 euro.

1.4 Në deklaratën *Vetting* subjekti deklaroi si burim krijimi të kësaj pasurie: shitjen e automjeteve të mëparshme në pronësi të saj, të ardhurat, ndër vite, të krijuara nga paga si gjuqtare, si dhe nga interesat e përfituara nga bonot e thesarit (ndër vite).

1.5 Komisioni hetoi mbi secilin burim të deklaruar nga subjekti dhe dokumentacionin e depozituar.

1.5.i Gjatë hetimit ka rezultuar se gjatë vitit 2016, subjekti ka shitur automjetet e mëposhtme:

- “Mini Cooper” me targa ***, datë 20.4.2016, në vlerën 4.500 euro;
- “Peugeot 3008” me targa ***, datë 4.7.2016, në vlerën 11.500 euro, të cilin subjekti e ka pasur në pronësi me të vëllanë A.L. dhe, për pasojë, shuma e përfitur nga kjo shitje është në vlerën 5.750 euro.

1.5.ii Shitja e këtyre dy automjeteve është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016 në seksionin e ndryshimeve të pasurisë.

1.5.iii Gjithashtu, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka depozituar në datën 9.8.2016 shumën 10.015 euro në llogarinë në BKT. Po në këtë datë është kryer transaksioni i kalimit të shumës 10.000 euro për shtetasin G.F.L. në bazë të kontratës së shitblerjes së automjetit nr. ***, datë 9.8.2016.

1.6 Komisioni kreu analizën duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e kryera deri në datën e blerjes së automjetit për dy persona (subjektin e rivlerësimit dhe djalin e saj).

1.6.i Lidhur me të ardhurat e realizuara nga shitja e automjetit tip “Mini Cooper” në vlerën 4.500 euro, Komisioni ka konstatuar³ se ky automjet është blerë me kontratën e shitjes nr. ***, datë 29.10.2014, me palë shitëse R. H. dhe blerëse Migena Laska. Vlera: 2.000 euro.

1.6.ii Komisioni kreu përlllogaritjet financiare duke marrë në konsideratë vetëm vlerën 2.000 euro të ardhura nga shitja e automjetit, ku konstatoi se subjekti ka pasur mundësi financiare të investojë në këtë pasuri, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

1.7 Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të sipërpërmendur, të administruar gjatë hetimit administrativ, konkludon se kjo pasuri është deklaruar me saktësi dhe vërtetësi nga subjekti i rivlerësimit, është krijuar me burime financiare të ligjshme në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Pra, në tërësi nuk u vërejt ndonjë problematikë lidhur me këtë pasuri.

2. Gjendje cash në vlerat 8.000 euro dhe 280.000 lekë.

³Referuar shkresës nr. *** prot., datë 12.8.2020, të DPSHTRR-së.

Burimi i krijimit: kursime ndër vite, nga paga si gjyqtare, si dhe nga të ardhurat nga interesat vjetore të investimit disavjeçar në bonot e thesarit pranë Bankës së Shqipërisë. Pjesa takuese, 100%.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

2.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* nga deklarata e parë para fillimit të detyrës, viti 2006 e në vazhdim, ndryshimet përkatëse (shtesa dhe pakësime) të likuiditeteve *cash*.

2.2 Sipas përlogaritjeve të Komisionit, në bazë të deklarimeve periodike të subjektit të rivlerësimit rezulton se subjekti në fund të vitit 2016 duhet të kishte gjendje shumën 572.210 lekë.

2.2.i Komisioni e ka pyetur⁴ subjektin mbi gjendjen *cash* në fund të çdo viti dhe, në përgjigje, subjekti ka deklaruar si në tabelën vijuese (shuma të pasqyruara në monedhat euro dhe lekë).

Tabela nr. 1

Data	Gjendje në euro	Gjendje në lekë
31.12.2006	350	2,193,293
31.12.2007	350	1,704,889
31.12.2008	350	2,198,933
31.12.2009	350	2,235,500
31.12.2010	350	4,991,301
31.12.2011	350	4,512,971
31.12.2012	350	4,512,971
31.12.2013	350	4,921,556
31.12.2014	7.800	5,153,109
31.12.2015	7.800	3,360,659
31.12.2016	8.000	280,000

2.3 Komisioni analizoi deklaratimet periodike (shtesa/pakësime) dhe përgjigjet e dhëna gjatë hetimit administrativ, nga ku konstatoi si vijon:

2.3.i Në deklaratën *Vetting* subjekti deklaroi se disponon shumat 8.000 euro dhe 280.000 lekë, ndërsa nga hetimi rezultoi se viti 2016 mbyllet me vlerën 572.210 lekë gjendje *cash*. Komisioni kreu analizën financiare deri më 24.1.2017, datë në të cilën është depozituar deklarata *Vetting*, për të parë mundësinë financiare të subjektit, për të krijuar gjendjen *cash* të deklaruar. Komisioni, nga përlogaritjet financiare konstatoi se dukej se: (i) subjekti nuk kishte pasur mundësi në shumën 746.475 lekë të shtonte gjendjen *cash*, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare; (ii) nuk përputhej deklarimi i subjektit në deklaratën *Vetting* mbi gjendjen *cash* 8.000 euro dhe 280.000 lekë me rezultatin e Komisionit në vlerën 572.210 lekë dhe, për pasojë, i kaloi barrën e provës në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

2.4 Në shpjegimet⁵ e saj, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se në vitin 2012 ka deklaruar: “Shtuar në bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë (500.000 lekë) me burim nga kursimet e të ardhurave vjetore 2012 mars 2012 dhe nga tërheqja e bonove të thesarit, ‘gjendja *cash*’, ‘nga tërheqjet për pjesëmarrje në ankandin primar të B.TH., kryer në datën 28, shuma 50.000 lekë’”. Sipas këtij deklarimi, subjekti ka specifikuar që shuma prej 500.000 lekësh e

⁴Pyetësor nr. 2, datë 1.2.2021.

⁵Referojuni shpjegimeve të subjektit në datat 6 dhe 17 maj 2021.

investuar në bono thesari në mars të vitit 2012 ka si burim kursimet nga të gjitha të ardhurat e saj vjetore, përgjatë gjithë vitit 2012, nga data 1.1.2012 deri më 31.12.2012, si dhe interesat e përfutuara nga bonot e thesarit po gjatë vitit 2012 (të cilat tërhiqeshin në sportelin e bankës që në momentin e investimit, pra që në mars të vitit 2012). Subjekti shprehet se në këto kushte, shuma prej 500.000 lekësh nuk duhet të zbritet nga kursimet *cash*, të cilat i ka pasur gjendje deri në datën 31.12.2011. Kjo sepse shuma e përdorur për investimin në bono thesari në muajin mars 2012 (500.000 lekë) është plotësuar dhe zëvendësuar duke u mbuluar tërësisht nga të ardhurat e saj vjetore deri në datën 31.12.2012, ku gjendja e saj *cash*, jo vetëm që nuk rezultonte e pakësuar, por është shtuar me vlerën 50.000 lekë në fund të vitit 2012. Subjekti ka pretenduar gjithashtu se: (i) analizës financiare, lidhur me gjendjen *cash*, i duhet shtuar edhe gjendja në monedhën euro - 350 euro, deklaruar që në deklarin e parë (para fillimit të detyrës), në datën 3.11.2006, në faqen nr. 4 të DPV-së vitit 2006; (ii) gjendjes totale *cash* duhet t'i shtohet edhe vlera 2.500 euro, e cila është vlera “e shtuar” në shitjen e automjetit në vitin 2016, për të cilën është paguar detyrimi⁶ tatimor⁷.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

2.5 Trupi gjykues, në analizë të provave të administruara, fakteve dhe rrethanave të cilësuar më sipër, përgjigjeve të subjektit në pyetësorë, parashtrimeve, si dhe provave të depozituara në funksion të barrës së provës, arsyeton si vijon:

2.5.i Lidhur me pretendimin e subjektit se shuma prej 500.000 lekësh nuk duhet të zbritet nga kursimet *cash* në vitin 2012, shpjegimet vlerësohen bindëse për disa argumente të qenësishme. Fakti që subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 (pra në kohë reale) ka qartësuar se burimi i shtesës së bonove të thesarit janë kursimet e të ardhurave vjetore në mars të vitit 2012 dhe nga tërheqja e bonove të thesarit faktin se shuma e përdorur për investimin në bono thesari në muajin mars të vitit 2012 prej 500.000 lekësh është zëvendësuar brenda vitit duke u mbuluar tërësisht nga të ardhurat e saj vjetore deri në datën 31.12.2012. Pra, gjendja *cash* është pakësuar në muajin mars të vitit 2012, në shumën 500.000 lekë, për t'u investuar në bono thesari dhe është shtuar në të njëjtën vlerë deri në fund të vitit me burim kursimet vjetore dhe interesat e bonove të thesarit të tërhequra në muajin mars në shumën 266.517 lekë. Si rezultat i këtyre transaksioneve, gjendja *cash* për investimin e kryer në shtimin e bonove të thesarit ka mbetur e pandryshueshme për shkak të zëvendësimit brenda vitit. Në këtë rast, i vetmi ndryshim në gjendjen *cash*, i cili është deklaruar nga subjekti po në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 është shtesa prej 50.000 lekësh, me burim nga tërheqja e interesave të bonove të thesarit në muajin mars të vitit 2012.

2.5.ii Lidhur me pretendimin se gjendjes *cash* i duhet shtuar edhe shuma prej 350 euro, e cila është deklaruar në deklarin e parë (para fillimit të detyrës), trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Kjo shumë është deklaruar në rubrikën e të ardhurave dhe angazhimeve në veprimtari publike dhe/ose private me përshkrimin kursime të realizuara nga dieta (shërbim pune në Lion, Francë) organizuar nga Shkolla e Magjistraturës dhe Këshilli i Evropës. Shuma prej 350 euro nuk merret në konsideratë për shkak se jo vetëm që nuk është deklaruar si gjendje *cash*, por edhe për faktin se dietat nuk konsiderohen të ardhura dhe kursime, praktikë kjo tashmë e konsoliduar edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelit⁸ (në vijim KPA), ku diktohet se nuk konsiderohen si të ardhura të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta vlerat monetare të përfutuara në formën e dietës për rimbursimin e shpenzimeve nga organizatorët e aktiviteteve të ndryshme profesionale, ku kanë qenë pjesëmarrës.

2.5.iii Lidhur me pretendimin se gjendjes totale *cash* duhet t'i shtohet edhe vlera 2.500 euro, e cila është vlera “e shtuar” në shitjen e automjetit në vitin 2016, për të cilën është paguar detyrimi tatimor, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk mund të merret në konsideratë

⁶Vërtetuar me shkresën zyrtare nr. *** prot., datë 5.5.2021, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë/DIVA 2016, deklaruar dhe paguar detyrimin tatimor, në shumën prej 15% të vlerës “e shtuar” nga çmimi i shitjes së këtij automjeti në vitin 2016.

⁷Vërtetim i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore.

⁸Vendim nr. 7 (JR), datë 5.4.2019.

faktin se subjekti, për blerjen e automjetit në vitin 2016 (trajtuar në pikën nr.1), ka deklaruar në deklaratën *Vetting* burim krijimi të ardhurat nga shitja e dy automjeteve, ku njëri prej tyre është automjeti i cili është shitur në vlerën 4.500 euro, duke nënkuptuar kështu kalimin e shumës në favor të blerjes së automjetit tip “Volkswagen Passat”, me targa ***. Subjekti i rivlerësimit, përveçse i ka vendosur një destinacion kësaj shume, nuk rezulton që në deklaratën e kohës të ketë deklaruar ndonjë shumë gjendjeje *cash* nga shitja e këtij automjeti. Pra, pavarësisht tatimit të paguar nga subjekti, kjo shumë ka shërbyer si burim për blerjen e automjetit dhe jo si gjendje *cash*.

2.6 Në përfundim, trupi gjykues, pas marrjes në konsideratë vetëm të pretendimit të subjektit për gjendjen *cash* në vitin 2012, rishqyrtoi nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor analizën financiare, duke kryer rillogaritjet përkatëse, nga ku rezultoi se balanca në datën 24.1.2017 shkon në vlerën 246.475 lekë, e cila në raport me vlerësimin tërësor të procesit nuk është e mjaftueshme që të ngrihet në nivelin e ndonjë kualifikimi ligjor për penalizimin e subjektit.

3. Investim në “obligacione thesari” në euro, në “Raiffeisen Bank”, datë emetimi 2.12.2016, datë maturimi 2.12.2018. Vlera: 49.000 euro. Burimi i krijimit të kësaj shume në euro është si vijon:

a) Shuma 25.533 euro – kursime të subjektit, të krijuara, ndër vite, nga puna si gjyqtare, si dhe nga interesat vjetore të përfituara nga investimi i kryer prej saj që në janar të vitit 2006 në bono thesari në Bankën e Shqipërisë. Shuma në lekë, e investuar fillimisht në bono thesari, në vitet 2006 - 2007, është pakësuar prej saj (duke tërhequr shumën 2.658.824 lekë) në vitin 2010. Shuma 2.658.824 lekë, e pakësuar nga bonot e thesarit në vitin 2010, i është shtuar kursimeve të subjektit në gjendje *cash*. Këto të ardhura dhe lëvizje financiare të kryera tërësisht në rrugë bankare janë mbledhur dhe deklaruar gradualisht ndër vite, në deklaratat periodike të pasurisë të dorëzuara vijueshmërisht në ILDKPKI, të cilat përkojnë me këto të dhëna dhe janë burim i kësaj gjendjeje *cash*. Në datën 7.10.2016, në zbatim dhe në respektim rigoroz të ligjit nr. 84/2016, subjekti i ka depozituar në llogari bankare me përshkrimin “depozitim në llogari personale”, në emër dhe për llogarinë e saj personale në “Raiffeisen Bank”.

b) Shuma 24.020 euro – dhurim i bërë nga bashkëjetuesi i subjektit, z. M. N., në datën 12.8.2014, me përshkrimin “kalim fondi për dhuratë” në “Raiffeisen Bank” (bazuar në vërtetimin bankar të kësaj banke). Burimi i kësaj shume është shitja e apartamentit me sip. 50 m², në pronësi të z. M. N., ndodhur në S., Kavajë (bazuar në kontratën noteriale të shitjes nr. ***, datë 28.4.2014, të nënshkruar para noterit publik), si dhe disa kursime të mëparshme po të z. M.N., të mbledhura ndër vite nga paga/honoraret, të ardhurat financiare si gazetar opinionist, publicist, moderator emisionesh televizive (13.370 euro + 2.000 euro + 8.650 euro = 24.000 euro (fakte këto të shoqëruara dhe të bazuara në kontratat përkatëse dhe vërtetimet bankare të “Raiffeisen Bank”, praktika përkatëse shoqëron dokumentet që depoziton në ILDKPKI, bashkëngjitur kësaj deklaratë). Pjesa takuese: 100%.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

3.1 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë investim në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016 me përshkrimin “shuma 49.000 euro është investuar në obligacione thesari në euro, në ‘Raiffeisen Bank’, datë veprimi 22.11.2016, datë emetimi 2.12.2016 dhe datë maturimi 2.12.2018”. Burimi i krijimit të kësaj shume rrjedh nga:

- vlera 25.533 euro (të sqaruara e të deklaruara më sipër në këtë deklaratë);
- vlera 24.020 euro (dhurim nga bashkëjetuesi i subjektit, z. M. N., bërë në datën 12.8.2014).

3.2 Për këtë pasuri subjekti ka depozituar së bashku me deklaratën *Vetting* edhe dokumentacionin përkatës⁹.

Hetimi i kryer nga Komisioni

⁹Aneks nr. 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

3.3 “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 24.8.2020, informon se subjekti i rivlerësimit ka investuar në obligacione shumë 49.000 euro, në datën 2.12.2016.

3.4 Për sa i përket dy burimeve të krijimit të këtij investimi, Komisionit i ka rezultuar si vijon:

3.4.i Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në llogarinë e saj në “Raiffeisen Bank”, në datë 7.10.2016, shumë 25.533 euro, me përshkrimin “derdh në llogari të ardhura nga puna, kursime në vite”.

Trupi gjykues ka analizuar në pikën nr. 2 të këtij vendimi gjendjen *cash* në fund të çdo viti sipas deklaramit periodik të subjektit, nga ku i ka rezultuar se në fund të vitit 2015 subjekti ka pasur gjendje shumë 4.076.104 lekë. Vërehet se kjo shumë është mëse e mjaftueshme për depozitim e kryer në datën 7.10.2016 nga subjekti.

3.4.ii Në datën 12.8.2014, në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank” është kryer transaksioni i kalimit të shumës 24.020,42 euro, nga shtetasi M. N. me përshkrimin “kalim fondi për dhuratë bashkëjetueses”.

3.4.iii Këtë transaksion subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014, duke cituar se burimi i shumës së dhuruar nga bashkëjetuesi vjen nga shitja e apartamentit në S., Kavajë, në vitin 2014, si dhe kursime të tjera që i dispononte dhuruesi më parë në llogarinë e tij në “Raiffeisen Bank”.

- Lidhur me këtë transaksion, Komisioni hetoi edhe llogarinë bankare në “Raiffeisen Bank” të bashkëjetuesit, shtetasit M. N., nga ku rezultoi se:

- në datën 16.5.2014 është kredituar shuma 13.370 euro nga noteri J. Zh., me përshkrimin “likuidim sipas kontratës¹⁰ nr. ***, datë 28.4.2014”;
- në datën 12.6.2014 është kredituar shuma 8.650 euro si rezultat i depozitimit *cash* nga z. M. N., me përshkrimin “derdhje në llogari, shitje apartamenti”;
- shuma 2.000 euro ishte gjendje në llogari si rezultat i dy depozitimeve *cash* të kryera nga z. M.N. në datat 14.1.2014 dhe 20.2.2014, në vlerën 1.000 euro secili depozitim.

3.5 Në analizim të transaksioneve të mësipërme që kanë shërbyer për plotësimin e shumës 24.020,42 euro, Komisioni arsyeton për secilin prej tyre si vijon:

❖ Për shumën 13.370 euro, të përfituar nga shitja e pasurisë

3.5.i Komisioni e ka pyetur subjektin e rivlerësimit për burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë, e cila u shit dhe u përdor si një ndër burimet për dhurimin e shumës 24.000 euro. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e dhëna nën disa argumente, nuk e ka vlerësuar bashkëjetuesin si person tjetër të lidhur përpara vitit 2014.

3.5.ii Komisioni, në kushtet kur subjekti gjatë hetimit pretendoi se z. M. N. për periudhën deri përpara vitit 2014 nuk cilësohet si person tjetër i lidhur, vlerësoi dhe analizoi situatën vetëm mbi të dhënat që arriti të disponojë përgjatë hetimit dhe në analizë të tyre, edhe pse më të dhëna të pamjaftueshme konstatoi se: (i) dukej se bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit nuk kishte pasur mundësi financiare¹¹ për të kryer investimet, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera përgjatë periudhës qershor 2007 – 4.7.2011; dhe se (ii) mungonte dokumentacion justifikues për provueshmërinë e burimit të ligjshëm të blerjes së pasurisë apartament, ku të ardhurat e përfituara nga shitja e tij kanë shërbyer për dhurimin ndaj subjektit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

3.6 Në shpjegime¹², ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar burimet e krijimit për këtë investim/obligacione sipas deklaramit të saj në deklaratën *Vetting*.

¹⁰Aneks nr. 4/3 në dojen e ILDKPKI-së, kjo kontratë shitje me nr. *** prot., datë 1.9.2020, konfirmohet edhe nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Kavajë.

¹¹Referojuni rezultateve të hetimit.

¹²Referojuni shpjegimeve të subjektit në datat 12, 14, 17 maj 2021.

3.6.i Lidhur me konstatimet e Komisionit subjekti ka shpjeguar se: “*Bashkëjetesa me personin e lidhur M. N. ka nisur që nga pranvera e vitit 2014, moment i cili përkon me fillimin e jetës sonë të përbashkët (në të njëjtën banesë), në banesën pronë e prindërve të mi, e ndodhur në qendër të Tiranës, në rrugën ‘***’, Tiranë. Ky është fillimi i detyrimit ligjor sipas të cilit bashkëjetuesi ka kryer deklarimin e pasurisë së tij, për herë të parë, në ILDKPKI si ‘person i lidhur’, deklarim ky i bërë në mënyrë krejtësisht të vullnetshme, të pa imponuar nga asgjë, shumë kohë më parë se të draftoheshin amendamentet kushtetuese 2016 dhe ligji nr. 84/2016. Përpara vitit 2014, M. N. nuk ka pasur asnjë detyrim ligjor për të deklaruar pasurinë e tij. Referuar edhe nenit 3 të ligjit nr. 85/2012, ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003’, i ndryshuar, parashikohet se: ‘Subjekti ka detyrimin për të deklaruar ‘interesat private që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga marrëdhëniet familjare apo të bashkëjetesës’. Subjekti i rivlerësimit nuk ka detyrim ligjor për të justifikuar pasuri të krijuara nga persona të tjerë, në një kohë në të cilën ata nuk kanë rezultuar persona të lidhur. Pasuritë e vëna nga M. N. përpara fillimit të bashkëjetesës ligjore, aq më tepër në kushtet kur ai rezultonte i lidhur në një martesë ligjore, e rregulluar nga regjimi pasuror i ‘bashkësisë ligjore’ – neni 73 i Kodit të Familjes, kanë qenë pjesë e bashkëpronësisë bashkëshortore, deri në momentin e zgjidhjes së martesës ligjore në datën 13.11.2012. Analiza financiare për ‘personin e lidhur’, bashkëjetuesin, duhet të kryhet vetëm lidhur me shumën 24.000 euro, e cila i është dhuruar subjektit të rivlerësimit, në gusht 2014. Kjo analizë duhet të shtrihet në harkun kohor 2010 – 2014¹³, duke marrë në konsideratë të ardhurat e krijuara nga puna dhe veprimtaria profesionale e z. N., përgjatë periudhës 2010 – 2014¹⁴. Pasuria e subjektit të rivlerësimit nuk lidhet në asnjë rrethanë dhe nuk ka si burim krijimi të saj pasurinë dhe të ardhurat e krijuara nga z. M. N. para vitit 2010”.*

3.6.ii Sipas subjektit, apartamenti me sip. 147 m², i ndodhur në Selitë, Tiranë, i blerë në janar të vitit 2009, në vlerën 60.000 euro nga z. M. N., është shitur në shkurt të vitit 2012 dhe pikërisht me të ardhurat e krijuara nga shitja e kësaj pasurie është blerë apartamenti me sip. 73 m² në F***, Tiranë. Apartamenti me sip. 73 m², në F***, në nëntor të vitit 2012 i është nënshtruar pjesëtimit të pasurisë bashkëshortore, mes ish-bashkëshortëve N., në momentin e zgjidhjes së martesës ligjore. Kjo tregon qartë që apartamenti me sip. 147 m², në Selitë, Tiranë ka qenë pjesë e pasurisë dhe e interesave pasurore martesore, krijuar gjatë martesës civile dhe i shitur po gjatë martesës civile. Për këtë arsye përfshirja e këtij apartamenti në analizë financiare nuk mund ta ngarkonte subjektin me përgjegjësi.

3.6.iii Subjekti, në kuadër të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, për të bërë të qartë se ka qenë tërësisht bashkëpunuese me këtë proces hetimor, ka depozituar provat e cituara më poshtë për të dokumentuar aktivitetin profesional, si dhe të ardhurat e ligjshme për të cilat, sipas saj, janë kryer të gjitha detyrimet tatimore sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, të krijuara nga puna e tij si gazetar, opinionist, editorialist, publicist, ideator dhe moderator programesh televizive, themelues i një faqeje *online* “Respublica”, etj., për një periudhë shumëvjeçare, e cila daton që nga viti 1998 e në vijim, pa asnjë ndërprerje (fakte gjithashtu të njohura e të ditura publikisht), si vijon:

- vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare, lidhur me punën e kryer në Ministrinë e Punëve të Jashtme, përgjatë periudhës janar 1996 – shtator 1997;
- vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare, lidhur me punën e kryer pranë subjektit “Spekter, Gazeta Shekulli”, përgjatë periudhës tetor 1998 – korrik 2005;
- vërtetim pagim honoraresh, lëshuar nga shoqëria “Botime Periodike Spekter” sh.a., (Gazeta Shekulli) për periudhën 2004 – 2005;
- vërtetim pagim honoraresh, përfshirë tatimin në burim, paguar nga shoqëria “Media 7” sh.a. – gazeta “Korrieri” dhe “Media 5” – revista “Klan” për periudhën 2006 – 2007;
- foto të gazetave (në variant *print*) në vitet 2005 – 2007, në të cilat z. M. N. shkruante dhe botonte editorialet e tij të përditshme, X21 foto;

¹³Bazuar në dokumentacionin që subjekti i rivlerësimit ka depozituar në përgjigjet e pyetësorit nr. 4.

¹⁴Shihni dokumentacionin dhe shpjegimet e dhëna në pyetësorët nr. 4 dhe nr. 5.

- fotokopje të gazetave, revistave të përditshme apo të përjavshme, në të cilat pasqyrohet puna e z. M.N. si gazetar, publicist, moderator emisionesh televizive, botues librash, si dhe pasqyrohet profili i tij mediatik dhe publik që nga vitet 1998 - 2000 e në vijim; po kështu edhe çmime ndërkombëtare të marra nga z. M.N. – “Saint Vicent” – marrë në Itali, personalisht nga presidenti italian z. C. A. C. në vitin 2004. Një çmim tepër prestigjioz në fushën e gazetarisë, çmim i cili është shoqëruar edhe me një vlerë financiare, rreth 7.000 euro (sikurse ai vetë kujton). Ky fakt përmendet edhe në një botim në gazetën e përditshme “Korrieri”, botuar në shtypin e shkruar shqiptar, në datën 14.12.2004 (bashkëngjitur kopjet e gazetës/ave, botime në shtypin e shkruar shqiptar, ndër vite).;
- vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, lidhur me punësimin e z. M. N. pranë subjektit “Top Channel”, përgjatë periudhës prill 2007 – gusht 2010;
- kontratë granti, e lidhur në datën 22.6.2011, fondacioni “****” dhe fondacioni “****”, përfaqësuar nga z. M.N., projekt në të cilin është paguar në cilësinë e koordinatorit, si dhe me honorare për shkrimet/editorialet e shkruara e të botuara sistematikisht, çdo ditë prej tij, në këtë *website*, të botuara *online*, në gazetën “Respublica”, themeluar prej tij;
- vërtetim pagim honoraresh, lëshuar nga “Universiteti ****”, përgjatë periudhës 13.9.2010 – 10.10.2013;
- *statement* bankar, lëshuar nga “Intesa Sanpaolo Bank” (x2), në të cilën pasqyrohen të ardhurat nga aktiviteti profesional i z. M.N. përgjatë periudhës 2007 – 2016;
- *statement* bankar, lëshuar nga “Credins Bank” (x2), në të cilën pasqyrohen të ardhurat nga aktiviteti profesional i z. M. N. përgjatë periudhës 2007 – 2014.

3.6.iv Subjekti ka sqaruar se referuar statementeve bankare (“Intesa Sanpaolo Bank”) të llogarisë së z. M. N., veç të ardhurave nga pagat dhe honoraret, ndër vite, vihen re edhe disa “derdhje *cash* në llogari”, të kryera prej tij. Subjekti sqaron se: “*Këto shuma e kanë burimin pikërisht nga honoraret të cilat i janë paguar M. N. në arkë, nga subjektet për të cilët ai ka ofruar shërbimet si gazetar. Kjo evidentohet edhe nga fakti që këto shuma janë thuarje të njëjta dhe të shpërndara në kohë në mënyrë periodike dhe të njëtrajtshme, pasi buronin nga pagesa honoraresh të përmuajshme për shërbimet (shkrime, opinione, editorial) që M. N. kryente në mënyrë të përditshme dhe të vazhdueshme. Pa ndërprerje. Lidhur me sa më sipër, kam dashur të provoj dhe të bëj me dije se z. M. N. ka pasur mjaftueshëm të ardhura dhe mundësi financiare¹⁵ për të krijuar dhe përballuar pasurinë dhe jetën e ndërtuar prej vetë tij, me punën dhe aktivitetin profesional si gazetar, publicist,¹⁶ moderator¹⁷, të cilin e kryen pa ndërprerje që nga viti 1998¹⁸ dhe në vijim”.*

3.6.v Gjithashtu, bashkëngjitur vërtetimeve zyrtare, subjekti ka vënë në dispozicion edhe foto të shkrimeve/editorialeve të kohës, të fotografuara në arkivin e Bibliotekës Kombëtare në Tiranë, të cilat përkojnë me periudhat e cituara në vërtetimet zyrtare¹⁹, si dhe adresa *online* – *You Tube*, të emisioneve televizive, ndër vite, të ideuara dhe të moderuara nga z. M. N. .

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

3.7 Trupi gjykues, pasi u njoh me dokumentacionin e depozituar në prapësime, mbi këtë çështje objekt vlerësimi, lidhur me shumën 13.370 euro, si pjesë përbërëse e shumës 24.020 euro, dhuruar nga bashkëjetuesi si një ndër burimet e krijimit të obligacioneve, identifikuar në këtë vendim (pika 3/ b, f. 8) arsyeton mbi situatat ligjore të dala nga hetimi administrativ.

- Së pari, trupi gjykues konstaton së ky dhurim ka plotësuar elementët e kërkuar nga pika 4, e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, pasi mbështetet në faktet provuese të tilla si: (i) ky dhurim është deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratën periodike vjetore; (ii) konfirmohet me transaksion bankar të bërë nga bashkëjetuesi në datën 12.8.2014, me përshkrim të identifikuar

¹⁵<https://www.youtube.com/ëatch?v=b5G7VxQpUMk>

¹⁶<https://www.youtube.com/watch?v=YCcz2EiaxpA>

¹⁷https://www.youtube.com/watch?v=GW9AUzgT_9E

¹⁸<https://www.youtube.com/watch?v=LFIVdgEWRBM>

¹⁹<https://www.youtube.com/watch?v=iyjE594FvZs>

për këtë qëllim, specifikuat “kalim fondi për dhuratë”; (iii) në mënyrë të drejtpërdrejtë burimi i ligjshëm i kësaj shume konfirmohet me të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit me sip. 50 m², në pronësi të bashkëjetuesit, i ndodhur në S***, Kavajë, sipas kontratës noteriale të shitjes nr. ***, datë 28.4.2014, të nënshkruar para noterit publik.

- Së dyti – lidhur me *indiciet* e identifikuar gjatë hetimit, të cilat çuan Komisionin për shtrirjen e një hetimi të thelluar, trupi gjykues çmon se:

3.7.i Në analizë të dokumentacionit të depozituar, lehtësisht provohet se të ardhurat e z. M.N. përfshijnë pagesa relativisht të larta, krijuar nga punë dhe angazhime të shumta ndër vite dhe deri aktualisht. Ky konstatim është rrjedhojë e një hetimi të plotë, gjithëpërfshirës dhe të lejuar, por kurrësi nuk mundet që pasuritë e krijuara nga bashkëjetuesi i subjektit gjatë jetës së tij bashkëshortore (ku bën pjesë edhe apartamenti i blerë në vitin 2011, të ardhurat e të cilit, pas shitjes iu dhuruan subjektit të rivlerësimit) t’i nënshtrohen analizës financiare për shkak të pranisë edhe të personave të tjerë në krijimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera, të cilët nuk kanë lidhje me subjektin e rivlerësimit, përfshirë edhe vetë bashkëjetuesin, i cili ka marrë këtë status prej vitit 2014. Një fakt tjetër i pakundërshtueshëm është ezaurimi i pjesëtimit vullnetar me marrëveshje të ndërsjellë në vitin 2012 nga palët bashkëshortore, pra nga bashkëjetuesi i subjektit dhe ish-bashkëshortja e tij e pasurive të krijuara.

3.7.ii Në mënyrë të përmbledhur, por edhe në një logjikë të drejtë arsyetimi, faktet që:

- bashkëjetuesi i subjektit deri në shtator të vitit 2012 ka rezultuar në një lidhje martesore;
- ka pasur pasuri të tjera të krijuara gjatë kësaj periudhe (blerje dhe shitje pasurish të paluajtshme);
- pasuritë i janë nënshtruar pjesëtimit me vullnet bashkëshortor, duke rezultuar në akte të pakontestuar mes palëve;
- këto pasuri nuk gjejnë kurrfarë lidhje me subjektin e rivlerësimit as në krijimin e tyre dhe, për pasojë, as edhe në tjetërsimin e tyre;
- pasuria që shërbeu si burim krijimi për dhurimin është blerë gjatë lidhjes martesore,

tregojnë qartazi që analiza për blerjen e pasurisë apartament, ku të ardhurat nga shitja e saj shërbyen si një ndër burimet e krijimit për dhurimin e bërë subjektit të rivlerësimit, nuk mund të shtrihet përpara vitit 2012.

3.7.iii Nën faktet e lartpërmendura, trupi gjykues e quan me vend por edhe të bazuar në ligj argumentin e përdorur nga subjekti se analiza financiare, bërë për llogari të bashkëjetuesit, nuk mund të përfshijë pasuri të cilat janë blerë dhe i janë nënshtruar pjesëtimit vullnetar midis dy bashkëshortëve në kohën e divorcit. Nga njëra anë, trupi gjykues çmon se këto janë fakte të rëndësishme të cilët nuk lejojnë ndërtimin e një situatë financiare të mirëfilltë deri në divorcin e bashkëjetuesit, por nga ana tjetër hetimi i zgjeruar i cili konkludoi në depozitim të akteve me provueshmëri të plotë të të ardhurave të bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit në jetën e tij gazetareske, publicistike dhe jo vetëm, i krijon trupit gjykues bindjen e plotë mbi ligjshmërinë e krijimit të pasurisë, e cila ka shërbyer si burim i një pjese të dhurimit të shumës totale 24.000 euro.

3.7.iv Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e personit të lidhur kanë rezultuar tërësisht të justifikuar, bazuar në dokumentacionin ligjor të depozituar nga subjekti i rivlerësimit që nga deklaratimet periodike (viti 2014 e në vijueshmëri), në deklaratimin *Vetting*, në pyetësorin standard, si dhe në pyetësorët e tjerë.

3.7.v Gjithashtu konkludohet se personi i lidhur i ka pasur mundësitë financiare për të përballuar si shpenzimet e tij përgjatë periudhës përkatëse të analizuar, ashtu edhe për të justifikuar ligjshmërinë e shumës së dhuruar subjektit të rivlerësimit në datën 12.8.2014 (nëpërmjet një transaksioni bankar në “Raiffeisen Bank”).

3.7.vi Në konkluzion, trupi gjykues, për këtë çështje objekt vlerësimi, çmon se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar bindshëm marrëdhënien e bashkëjetesës, interesat pasurore, në rastin

konkret dhurimin në favor të saj, i cili ka shërbyer si burim krijimi për pasurinë, investim në obligacione.

❖ Për shumën 8.650 euro, depozitim *cash* me përshkrimin “derdhje në llogari, shitje apartamenti”

3.8 Në vijim të hetimit për ligjshmërinë e shumave të deklaruara si burim për këtë investim/obligacione, Komisioni ka pyetur²⁰ subjektin e rivlerësimit lidhur me provueshmërinë e përshkrimit të këtij depozitimi. Subjekti, në përgjigjen e dhënë, ka deklaruar: “Lidhur me shumën 8.650 euro, të cilën rezulton që z. M. N. e ka derdhur në datën 12.6.2014, në ‘Raiffeisen Bank’, *cash*, në llogarinë e tij personale, depozitim për të cilin është shkruar me përshkrimin ‘derdhje në llogari, shitje apartamenti’, ky është një përshkrim që kryhet jo nga vetë klienti, por nga punonjësi i bankës. Në rastin konkret, rezulton që përshkrimi ‘derdhje në llogari, shitje apartamenti’, është një lapsus/gabim material, i bërë nga punonjësi i bankës. Jo nga z. M. N. . Kjo shumë nuk lidhet me shitjen e asnjë apartamenti. Dhe as të ndonjë prone tjetër. Nuk rezulton që z. M. N. të ketë shitur asnjë pronë (apo apartament) në vlerën 8.650 euro. Shuma 8.650 euro buron nga kursimet që z. M. N. ka arritur të krijojë nga të ardhurat e tij të ligjshme, nga aktiviteti profesional dhe intelektual i kryer prej tij. Dokumentacionin ligjor, lidhur me këto të ardhura, e kam shpjeguar dhe depozituar bashkëngjitur pyetësorit nr. 4, dorëzuar në Komision, në datën 1.4.2021”.

3.9 Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës lidhur me shumën 8.650 euro, depozitim *cash*, në kushtet që sipas *statementit* bankar kjo derdhje rezultonte me përshkrimin “derdhje në llogari, shitje apartamenti” dhe jo nga ardhurat nga paga, pasi dukej se nuk provohej burimi i ligjshëm i shumës 8.650 euro, e cila kishte shërbyer si burim për dhurimin, duke i kërkuar edhe dokumentacion justifikues.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

3.10 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj, lidhur me shumën 8.650 euro, derdhur *cash* nga z. M.N., në datën 12.6.2014, në llogarinë e tij personale në “Raiffeisen Bank”, me përshkrimin “derdhje në llogari, shitje apartamenti”, ndër të tjera, përveçse ka ripërsëritur shkakun se përshkrimi i transaksionit është një lapsus/gabim material, i bërë nga punonjësi i bankës, ka sqaruar se ky përshkrim “derdhje në llogari, shitje apartamenti”, nuk shoqërohet me asnjë citim konkret, asnjë kontratë shitjeje apartamenti, lidhur me të dhënat konkrete (numër, datë, etj.) të ndonjë kontrate eventuale të shitjes së një apartamenti. Nuk rezulton që z. M. N. të ketë shitur ndonjë pronë (apo apartament) në vlerën 8.650 euro. Subjekti është shprehur se: “... sikurse është konstatuar edhe në rezultatet e këtij hetimi administrativ të kryer nga Komisioni, pas konfirmimeve zyrtare të marra nga të gjitha zyrat e ASHK në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë (kjo referuar të dhënave të hetimit administrativ që më janë vënë në dispozicion në CD nga vetë Komisioni), z. N. nuk ka kryer shitje të asnjë apartamenti apo çfarëdo prone tjetër, në shumën 8.650 euro. Po kështu, pronat e shitura nga z. N. janë të deklaruara nga subjekti dhe personi i lidhur me të, sikurse edhe të evidentuara plotësisht nga Komisioni në kuadër të këtij hetimi administrativ. Asnjë nga këto shitje (të deklaruara dhe të evidentuara) nuk përkon me këtë vlerë. Po kështu vlen të theksohet fakti se, në vitin 2014, kur rezulton të jetë kryer kjo ‘derdhje në llogari personale’, pagesa e çmimit të shitblerjes së një apartamenti/pasuri e paluajtshme, kryhej sikurse edhe aktualisht, nëpërmjet llogarisë bankare (me transaksion bankar) të Noterit Publik, pranë të cilit kryhej dhe vërtetohej veprimi juridiko-civil i shitblerjes. Në të kundërt prona objekt kontrate shitje nuk mund të kalonte nga shitësi tek blerësi. Pikërisht në këtë mënyrë është vepruar edhe në rastin e shitjes së apartamentit me sip. 50 m², ndodhur në S., Kavajë, kryer me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 28.4.2014. Vlera e çmimit të shitjes së këtij apartamenti i ka kaluar z. N. në llogarinë e tij bankare në ‘Raiffeisen Bank’, nga llogaria bankare e Noterit Publik, në datën 16.5.2014, me përshkrimin: ‘Likuidim sipas kontratës nr. ***, datë 28.4.2014’. Të gjitha këto fakte dhe rrethana konkrete tregojnë qartë se z. M. N. nuk ka shitur asnjë apartament/pronë në këtë vlerë

²⁰Pyetësori nr. 5, datë 20.4.2021.

8.650 euro. Jo vetëm kaq, por subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë provuar dhe dokumentuar plotësisht burimin e ligjshëm të shumës 8.650 euro = kursime nga puna e kryer (M. N.) në disa vite²¹, duke depozituar dokumentacionin ligjor përkatës që lidhet me të ardhurat nga aktiviteti profesional i M. N. përgjatë periudhës 2010 – 2014”.

3.10.i Subjekti, për të mbështetur deklarin e saj lidhur me këtë transaksion, ka depozituar edhe shkresën²² me informacionin e dhënë nga “Raiffeisen Bank”.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

3.11 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, duke e vlerësuar veprimin financiar të kryer nga bashkëjetuesi në favor të subjektit, si të vullnetshëm, përpara një institucioni bankar, që ka tagrin të kërkojë më shumë informacion mbi një transaksion të kryer, por edhe të kërkojë provueshmërinë me dokumentacion, konstaton se në fakt nuk ka pasur një marrëdhënie shitblerjeje pasurie e rakorduar me këtë shumë të depozituar. Shpjegimi i subjektit se një veprim noterial shitblerjeje pasurie do të realizohej nëpërmjet llogarisë së noterit është i drejtë dhe i bazuar në ligjin e “Noterisë”. Ky argument, gjithashtu, merr një vlerë të caktuar dhe mbështet pretendimin se përshkrimi i transaksionit ka qenë thjesht dhe vetëm një lapsus i punonjësit të bankës. Trupi gjykues çmon se shkresa nr. *** prot., datë 11.5.2021, e “Raiffeisen Bank” sh.a., mbështet edhe shpjegimet e subjektit për këtë situatë se nuk ka rezultuar asnjë e dhënë apo dokument tjetër si kontratë noteriale, dokument ligjor, deklaratë, vërtetim apo mandatpagesë që të kenë lidhje me shitjen e ndonjë apartamenti. Nga ana tjetër, trupi gjykues vlerëson në këtë arsyetim edhe faktin se bashkëjetuesi i subjektit rezultoi me të ardhura të mjaftueshme por edhe me pasuri të krijuara më parë, të cilat i janë nënshtruar pjesëtimit bashkëshortor, por që gjithashtu prej shitjes së tyre ka krijuar të ardhura apo edhe kursime, për të cilat, u arsyetua më sipër.

3.11.i Në vlerësim objektiv të trupit gjykues mbetet fakti që transaksioni është kryer në rrugë bankare dhe se arsyetimi më sipër mbështet përshkrimin e këtij transaksioni si një lapsus, për sa kohë nga analizimi i të dhënave tërësore për këtë situatë (*sikurse rezultoi edhe vlera e transaksionit në vetvete në shumën 8.650 euro*), nuk u evidentua ndonjë e dhënë tjetër për të ngritur dyshime për këtë transaksion. Po në këtë drejtim, trupi gjykues evidenton edhe faktin se nga analiza financiare e kryer për këtë shumë, personi i lidhur ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e saj nga kursimet e pagave.

❖ Për depozitimet *cash* nga z. M. N., në datat 14.1.2014 dhe 20.2.2014, në shumën 1.000 euro secili depozitim.

3.12 Trupit gjykues, nga analiza financiare, nuk i rezultuan problematika për krijimin e burimit tjetër në vlerën 2.000 euro (krijuar me të ardhurat nga pagat e bashkëjetuesit, depozitime *cash* prej tij në datat 14.1.2014 dhe 20.2.2014, nga 1.000 euro secili depozitim), i cili ka shërbyer në plotësimin e shumës së dhuruar subjektit në vlerën 24.000 euro.

✓ Në përfundim, për pasurinë investive në obligacione me burim krijimi kursime dhe për dhurimin e bërë nga bashkëjetuesi, trupi gjykues konkludon se janë krijuar me burime të ligjshme sipas pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

4. Investime në “obligacione thesari” në lekë – blerje letrash me vlerë, me afat 24-mujor, me datë emetimi 24.10.2016 dhe datë maturimi 24.10.2018 në “Raiffeisen Bank”. Vlera: 3.700.000 lekë. Burimi i kësaj shume të hollash është investimi i mëparshëm i subjektit në bono thesari, pranë Bankës së Shqipërisë, investim ky i nisur prej saj që në janar të vitit 2006 (përpara se të emërohej e të kryente detyrën e gjyqtarit).

- Nga investimi i bërë në bono thesari, në harkun e 11 viteve (2006 – dhjetor 2016), subjekti ka arritur të përfitojë të ardhura nga interesat vjetore në shumën totale 2.462.841 lekë.

²¹Dokumentacioni ligjor justifikues është dorëzuar nga subjekti në Komision, në datën 1.4.2021, bashkëngjitur pyetësorit nr.4.

²²Shkresë nr. *** prot., datë 11.5.2021.

- Shuma 5.000.000 lekë – burimi i shumës së investuar nga subjekti, në vitin 2006 në bono thesari, është shitja e një apartamenti me sip. 74 m², të ndodhur në rrugën “****” në Tiranë, bazuar kjo në kontratën noteriale nr. ***, datë 18.7.2005, hartuar para noterit publik “kontratë shitblerjeje me kusht kreditimi”. Shumën e parave të përfituara në rrugë bankare nga shitja e këtij apartamenti, subjekti e ka investuar në janar të vitit 2006, në bono thesari, pranë Bankës së Shqipërisë.
- Ndërsa apartamentin me sip. 74 m², të ndodhur në rrugën “****”, në Tiranë, subjekti e ka blerë bazuar në kontratën noteriale nr. ***, datë 13.4.2004, të hartuar para noterit publik “kontratë shitblerjeje”. Çmimi i blerjes së këtij apartamenti ka qenë 1.950.000 lekë. Burimi i kësaj shume kanë qenë kursimet nga puna e subjektit disavjeçare e kryer *part time*, përgjatë kohës që ka studiuar dhe jetuar në M. - Itali (detajet i shpjegon më hollësisht në rubrikat e posaçme e më poshtë), si dhe kontributi i dhënë në të holla nga ish-bashkëshorti në lidhje me detyrimet e tij në raport me fëmijën (në kushtet kur rritja dhe edukimi i tij, djalit Ch. R.Laska, si dhe në tërësi përgjegjësitë prindërore dhe angazhimi ndaj tij, bazuar edhe në vendimin gjyqësor të formës së prerë, i ish-in lënë dhe besuar asaj, si nënë). Ky kontribut financiar nuk është kryer në mënyrë të formatizuar (me mandatpagesa) mes tyre, pasi nuk kanë pasur as arsye dhe as ndonjë detyrim ligjor për këtë gjë, si dhe nuk ka pasur as nevojë për praktika përmbarimore. Pjesa takuese: 100%.

4.1 Për këtë pasuri subjekti ka depozituar së bashku me deklaratën *Vetting* edhe dokumentacionin përkatës²³.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

4.2 Subjekti deklaron në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016: “*Riinvestim, po në bono thesari, në lekë, në ‘Raiffeisen Bank’, datë veprimi 14.10.2016, datë emetimi 24.10.2016, datë maturimi 24.10.2018. Burimi i krijimit i shumës 3.700.000 lekë është nga gjendja e mëparshme e bonove të thesarit*”.

Hetimi i kryer nga Komisioni

4.3 Nga korrespondenca e Komisionit me “Raiffeisen Bank”²⁴ dhe Bankën e Shqipërisë²⁵ ka rezultuar se historiku i investimeve ka qenë si vijon:

- datë 11.1.2006, znj. Migena Laska ka depozituar në llogarinë e saj në “Raiffeisen Bank” shumën 4.000.000 lekë;
- datë 16.1.2006, subjekti i rivlerësimit, shumën e depozituar prej 4.000.000 lekësh, e investon në bono thesari, nga e cila pranohet në ankandin nr. *** (12-mujor) vetëm vlera 2.814.210 lekë. Diferenca prej 1.185.790 lekësh (4.000.000 - 2.814.210) është rikthyer në llogari;
- në datën 30.1.2006 shuma e akumuluar deri në këtë datë në llogari, prej 1.363.900 lekësh është investuar në bono thesari, nga e cila është pranuar në ankandin nr. *** (12-mujor) vetëm vlera 1.360.000 lekë. Diferenca prej 3.900 lekësh është rikthyer përsëri në llogarinë e “Raiffeisen Bank”.

4.3.i Këto dy ankande janë maturuar dhe kthyer në llogarinë e “Raiffeisen Bank”:

- në datën 18.1.2007 shuma 2.814.210 lekë; dhe
- në datën 1.2.2007 shuma 1.360.000 lekë.

4.3.ii Në datën 5.2.2007 subjekti ka depozituar në llogarinë e saj në “Raiffeisen Bank” shumën prej 1.055.995 lekësh.

4.4 Totali i të gjitha shumave të mësipërme (ankandet e maturuara dhe depozitimi *cash*) është investuar në bono thesari në datën 5.2.2007, në shumën 5.200.000 lekë, e cila ka qenë e investuar në bono thesari deri në shkurt të vitit 2010. Në datën 11.02.2010, subjekti ka kryer

²³Aneks nr. 4/3 dhe nr. 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁴Shkresë nr. *** prot., datë 24.8.2020.

²⁵Shkresë nr. *** prot., datë 7.8.2020.

pakësim të bonove të thesarit, duke tërhequr nga investimi shumë prej 2.658.824 lekësh. Këtë shumë e ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 si gjendje *cash*, ndërsa në vitin 2011 e ka shtuar këtë investim me 700.000 lekë dhe në vitin 2012 me 500.000 lekë. Burimi i shtesave të bonove të thesarit vjen nga gjendja *cash* e akumuluar ndër vite.

4.5 Investimet në bono thesari (maturim 12-mujor) kanë vazhduar deri në vitin 2015 dhe në vitin 2016 investimi është kryer për obligacione (maturim 24-mujor).

4.6 Në mënyrë të përmbledhur investimet në vite kanë qenë si vijojnë:

Tabela nr. 2

Data e emetimit	Vlera nominale
17.1.2006	2,814,210
2.2.2006	1,360,000
15.2.2007	5,200,000
14.2.2008	5,200,000
12.2.2009	5,200,000
18.2.2010	2,122,369
4.3.2010	540,000
3.3.2011	3,340,000
15.3.2012	3,810,000
15.3.2013	3,810,000
13.3.2014	3,810,000
9.4.2015	3,789,000
24.10.2016	3,700,000

✓ Për sa më sipër, në analizë të dokumentacionit të depozituar konfirmohet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga “Raiffeisen Bank” se investimi në obligacione është në vlerën 3.700.000 lekë.

Lidhur me burimin e krijimit

4.7 Nga korrespondenca e Komisionit me ASHK-në Drejtoria Vendore Tiranë Veri²⁶, në informacionin e përcjellë ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur në pronësi apartamentin ap. nr. ***, k. ***, i përbërë nga një dhomë e një kuzhinë dhe ambiente të tjera ndihmëse me sip. 74 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, në rrugën “****”, Tiranë, godinë trekatëshe, i blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 13.4.2004, apartament + truall përkatës me palë shitëse A. A. dhe pëlqimdhënëse A.A. dhe palë blerëse Migena Laska. Çmimi i shitjes është vendosur në shumë 1.950.000 lekë. Shuma është likuiduar tërësisht dhe jashtë kësaj zyre nga pala blerëse.

4.8 Më pas, kjo pasuri është shitur me kontratë shitblerjeje me kusht kreditimi nr. ***, datë 18.7.2005, mes palës shitëse Migena Laska dhe palës blerëse F.L. (nëna e subjektit), në vlerën 6.500.000 lekë. Çmimi i shitjes përfshin vlerën e apartamentit dhe mobilimin e brendshëm. Në kontratën e shitjes është cituar se shuma prej 1.500.000 lekësh është likuiduar para përpilimit të kontratës jashtë zyrës noteriale dhe diferenca prej 5.000.000 lekësh do të likuidohet nëpërmjet kredisë bankare në “Raiffeisen Bank”.

4.9 Në vijim të hetimit të burimit ka rezultuar se në datën 7.10.2005, znj. F. L. ka tërhequr nga “Raiffeisen Bank” shumë 4.950.000 lekë, shumë kjo e përfituar nga disbursimi i kredisë.

4.10 Në deklaratën përpara fillimit të detyrës (viti 2006) subjekti ka deklaruar: “Gjendje *cash* + letër me vlerë (bono thesari), (1.000.000 + 4.000.000 lekë), blerë nëpërmjet ‘Raiffeisen Bank’, me maturim 12-mujor, emetuar në datat 17.1.2006 dhe 2.2.2006. Burimi i krijimit: nga

²⁶Shkresë nr. *** prot., datë 30.9.2020.

shitja e apartamentit në vlerën 5.000.000 lekë që ka qenë e krijuar nga të ardhurat e punës dhe kursimet e mia disavjeçare, si dhe nga kontributi i ofruar prej ish-bashkëshortit tim”.

4.11 Subjekti, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, ka deklaruar: *“Shtesa nga deklarimi i mëparshëm i bonove të thesarit 200.000 lekë. Aktualisht gjendje të bonove të thesarit të riemtuara është 5.200.000 lekë më 31.12.2007”.* Por, duke parë gjendjen e bonove të thesarit në fund të vitit 2006, që është në shumën 4.174.210 lekë (2.814.210 + 1.360.000) shtesa e deklaruar prej 200.000 lekësh nuk përputhet me gjendjen prej 5.200.000 lekësh. Shtesa e bonove të thesarit nga viti 2006 në vitin 2007 rezulton të jetë në shumën 1.025.790 lekë.

4.12 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 burimin e krijimit të shtesës së bonove të thesarit.

4.13 Gjatë hetimit ka rezultuar se në datën 5.2.2007 subjekti ka depozituar në llogarinë e saj në “Raiffeisen Bank” shumën 1.055.995 lekë, e cila ashtu siç u përmend më sipër, së bashku me maturimet e dy investimeve të mëparshme është investuar në shumën 5.200.000 lekë në bono thesari.

4.14 Komisioni e ka pyetur²⁷ subjektin për këtë mospërputhje në deklarim dhe për vlerën reale të investuar në bono thesari dhe, ndër të tjera, në përgjigjen e saj subjekti sqaron se: *“Duke qenë se qëllimi im determinant që në krye të herës ishte investimi në bono thesari i të gjithë shumës 5.000.000 lekë, me qëllim përfitimi sa më të lartë të interesave vjetore, unë këtë gjë arrita ta finalizoj, pikërisht në muajin shkurt 2007. Diferencën që më kishte mbetur, të cilën e kisha konsideruar të destinuar vetëm për këtë qëllim (dhe jo në kuadër të një gjendjeje cash për nevoja familjare ose personale), e kam derdhur vetë personalisht në ‘Raiffeisen Bank’ në datën 5.2.2007, me qëllim shtimin dhe plotësimin e investimit tim financiar në bono thesari, pikërisht në shumën 1.055.995 lekë”.*

4.15 Komisioni kreu analizën financiare në datën 5.2.2007, kur është kryer investimi nga ku i rezultoi se dukej se: (i) subjekti i rivlerësimit nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 977.217 lekë të kryente këtë investim, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare; (ii) nuk përputhej shtesa e bonove të thesarit prej 200.000 lekësh të deklaruar nga subjekti me atë të rezultuar gjatë hetimit prej 1.025.790 lekësh; (iii) nuk justifikohet veprimi financiar i shitjes së apartamentit (nënës), blerë në vlerën 1.950.000 lekë (viti 2004) dhe shitur në shumën 6.500.000 lekë (viti 2005), si dhe ishte i paqartë veprimi tatimor lidhur me regjistrimin e kësaj pasurie.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

4.16 Subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e tij, ndër të tjera, për konstatimin (i) dhe (ii) ka shpjeguar se: *“... me kontratë shitblerjeje me kusht kreditimi nr. ***, datë 18.7.2005, kam shitur një apartament me sip. 74 m², në vlerën totale 6.500.000 lekë të reja. Shuma 1.500.000 lekë të reja më është likuiduar nga nëna ime (në cilësinë e blerëses) përpara nënshkrimit të kësaj kontrate. Shuma 5.000.000 lekë të reja më është likuiduar nga nëna ime me disbursimin e kredisë së marrë prej saj, në datën 7.10.2005, në ‘Raiffeisen Bank’.*

Në datën 31.12.2005, siç më ka llogaritur dhe Komisioni, bazuar edhe në të gjitha deklaratimet e mia, gjendja në total e likuiditeteve ka qenë: 6.539.025 lekë.

Siç kam deklaruar dhe më parë nga shuma totale që disponoja, kisha planifikuar që shumën 5.000.000 ta investoja në bono thesari.

Në vitin 2006 kam arritur të investoj shumën 4.000.000 lekë, pasi aq u pranuan në ankandet e zhvilluara në atë vit (2006).

²⁷Pyetësor nr. 2, datë 20.1.2021.

Rrjedhimisht, shumën 1.000.000 lekë e kam mbajtur cash deri në momentin që do të zhvillohej ankandi i radhës (datë 15.2.2007).

Përveç kësaj shume unë kisha gjendje cash dhe gjendjen që kam deklaruar në DPV dhe të llogaritur nga Komisioni në shumën 1.050.000 lekë.

Pra, gjendja e likuiditeteve në total është pak a shumë e njëjta me gjendjen në vitin 2005, në vlerën 6.250.000 lekë.

*Në vitin 2007 kam deklaruar ‘gjendja e bonove të thesarit më 31.12.2007 5,200,000 lekë shtesa 200.000 lekë’, pasi gjithmonë konsideroja që shuma 5.000.000 lekë ishte gjendje në bono thesari dhe shtesa ishte vetëm 200.000 lekë, gjë që lidhet ngushtësisht me atë çfarë unë kam deklaruar në vitin 2006. Shuma 1.055.995.00 lekë ka burim të ligjshëm ‘kontratë shitblerjeje me kusht kreditimi’ nr. ***, datë 18.7.2005, lidhur me shitjen e apartamentit në vlerën totale 6.500.000 lekë të reja. Pra, nuk bëhet fjalë për një burim të shtuar. Është i njëjti burim i disponuar që nga data 31.12.2005. Theksoj, sikurse edhe në deklaratën Vetting, se shuma e investuar në bono thesari në lekë, në Bankën e Shqipërisë, deri në shkurt të vitit 2007, në shumën totale 5.200.000 lekë, e ka burimin nga shitja e apartamentit në vlerën totale 6.500.000 lekë. Edhe në deklaratën Vetting, dorëzuar në ILDKPKI në datën 24.1.2017, në faqen nr. 6 të këtij deklarimi, kam sqaruar qartësisht investimin e bërë nga ana ime që nga muaji janar 2006 e në vijim në bono thesari në Bankën e Shqipërisë dhe, më tej, në obligacione thesari në lekë, pranë ‘Raiffeisen Bank’, ku ndër të tjera kam sqaruar se shuma 5.000.000 lekë (me burim të ligjshëm ‘kontratë shitblerjeje me kusht kreditimi’ nr. ***, datë 18.7.2005) është investuar nga ana ime në bono thesari. Edhe “gjendja cash” e deklaruar nga unë, deri në datën 31.12.2016 (në deklaratën Vetting) është një rrjedhojë krejtësisht faktike, logjike, aritmetike dhe ligjore që starton që me gjendjen financiare fillestare, që unë realisht kam pasur mundësi të kem që nga data 31.12.2005. Shumë kohë përpara deklaratimit fillestar dhe fillimit të detyrës si gjyqtare. Rrjedhimisht, lidhur me pikat nr. 4.14 – 4.18, të “Rezultateve të Hetimit Administrativ”, analiza financiare e pasqyruar në tabelën nr. 8, duhet rivlerësuar duke përfshirë me saktësi burimin e plotë dhe të ligjshëm me të cilin është krijuar investimi në bono thesari në lekë, në Bankën e Shqipërisë”.*

4.16.i Subjekti ka kërkuar që Komisioni të marrë në konsideratë të gjitha shpjegimet, faktet, provat e paraqitura²⁸, duke e rishqyrtuar analizën financiare lidhur me këtë pikë dhe duke i konsideruar të plota të ardhurat e saj sikurse rezultojnë të evidentuara në prova dhe në shpjegimet e paraqitura, bazuar edhe në deklaratën Vetting (viti 2017).

4.16.ii Ndërsa për konstatimin (iii), subjekti ka shpjeguar se veprimi juridiko – civil, kontrata e shitblerjes së apartamentit me sip. 74 m², kryer në vitin 2005, është një veprim i parashikuar në mënyrë eksplicite nga neni 705 e vijues i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Është një veprim juridik i bazuar mbi vullnetin e lirë e të pavesuar të palëve kontraktore. Është një veprim juridiko-civil i kryer dhe i vërtetuar përpara Noterit Publik, në respektim me të gjithë legjislacionin në fuqi²⁹. Është një veprim juridik në të cilin pala shitëse konkretizon dhe provon burimin e kësaj pasurie dhe pala blerëse justifikon plotësisht burimin e çmimit të blerjes së këtij apartamenti. Në respektim të kësaj kontrate shitblerjeje, si dhe në respektim të legjislacionit në fuqi është kryer edhe pagesa lidhur me rivlerësimin e apartamentit, dorëzuar në ZRPP Tiranë³⁰. Kjo pagesë është kryer pikërisht në momentin kur znj. F. L. ka likuiduar plotësisht kredinë kundrejt “Raiffeisen Bank” dhe apartamenti është çliruar nga “barra hipotekore”, vënë për llogari të bankës dhe me kryerjen e pagesës së rivlerësimit nga ana e shitësit Migena Laska është kryer edhe kalimi i pronësisë në regjistrat e ASHK-së në emër të znj. F. Laska. Ky veprim është kryer përpara se subjekti i rivlerësimit të plotësonte dhe të dorëzonte deklaratën Vetting. Pra, nuk është kryer për shkak të procesit Vetting, por vetëm në respektim të ligjit. Vlera e paguar për rivlerësimin e këtij apartamenti është më e madhe se 3%

²⁸Dorëzuar me deklaratën Vetting në janar të vitit 2017, si dhe në përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

²⁹Shpjegime të detajuara lidhur me shitjen e këtij apartamenti, kam dhënë gjithashtu edhe në përgjigjet e pyetësorëve nr. 2 dhe nr. 4, dorëzuar në Komision.

³⁰Shoqëruar mandatpagesat e “Credins Bank”, lidhur me kryerjen e detyrimit tatimor.

e vlerës së përfituar nga shitja e këtij apartamenti. Pra, jo vetëm që justifikohet dhe dokumentohet plotësisht veprimi financiar i shitjes së këtij apartamenti, por njëkohësisht subjekti i rivlerësimit ka kryer pagesën e detyrimit tatimor, duke përmbushur kështu çdo obligim ligjor në fuqi (pika 4.10 – 4.11). Ky veprim financiar është krejtësisht i justifikueshëm edhe në kuptim të fakteve dhe të rrethanave konkrete. Nëna ime, në vitin 2005, ka bërë këtë zgjedhje krejtësisht të vullnetshme, duke dashur të mbrojë njëkohësisht interesat e dy fëmijëve të saj. Teksa ka menduar që nëpërmjet këtij veprimi të sigurojë një banesë për djalin e saj të madh dhe familjen e tij të sapokrijuar në atë kohë, duke i akomoduar ata në një apartament në qendër të Tiranës, vlera e të cilit (si rregull) vetëm do të rritej me kohën dhe që në të njëjtën kohë është kujdesur të mos dëmtojë dhe të mos zhvlerësojë pasurinë, interesat pasurore të vajzës së saj të vetme, e cila në atë moment ishte 26 vjeç, ishte kryefamiljare, e divorcuar dhe kujdestare e një fëmije të vogël, vetëm 7 vjeç dhe jetonte vetëm me djalin e saj. Subjekti shprehet se nëse nëna do t'i kishte kërkuar të shiste shtëpinë e saj (për të akomoduar aty vëllain, bashkëshorten dhe djalin e tij), në të njëjtën shumë që e kishte blerë (1.950.000 lekë), investimi i saj pasuror dhe mundësia që i ishte dhënë për ta blerë atë apartament në atë çmim, do të shkonte dëm dhe gjithçka që kishte arritur do të ishte zhvlerësuar (në kohë). Ky veprim financiar, i kryer kohë para se subjekti të fillonte detyrën e gjyqtares, ka pasur për qëllim ruajtjen e disa interesave financiare brenda familjes dhe, për këtë, ka menduar vullnetshëm, me shumë përkushtim, korrektësi dhe shpirtmadhësi, nëna dhe babai i saj.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

4.17 Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të subjektit, nuk konkludoi në një vlerësim ndryshe nga konstatimi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 977.217 lekë të kryente këtë investim, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare. Ky konkludim konsiston i tillë pasi trupi gjykues nuk merr në konsideratë pretendimin e subjektit lidhur me gjendjen *cash*. Argumenti ligjor bazë në këtë rast çmohet se është zbatimi i ligjit nr. 9049/2003 i ndryshuar, i cili ka parashikuar detyrimin e subjekteve deklaruese, ku sipas tij, subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si vijon: “ (a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to; (d) [...]vlerën e likuiditeteve, gjendje cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj; (dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj; (e) të ardhurat personale për vitin nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale; [...]”, nga ku nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar saktë gjendjen e saj të likuiditeteve.

4.17.i Më konkretisht, subjekti, në deklaratën para fillimit të detyrës ka deklaruar se dispononte shumat 1.000.000 lekë *cash* dhe 4.000.000 lekë në bono thesari, me burim “nga shitja e apartamentit në vlerën 5.000.000 lekë që ka qenë e krijuar nga të ardhurat e punës dhe kursimet e mia disavjeçare, si dhe nga kontributi i ofruar prej ish-bashkëshortit tim”. Për rrjedhojë të këtij deklarimi, trupi gjykues nuk mund të prezumojë se subjekti e ka pasur diferencën prej 1.500.000 lekësh nga shitja e apartamentit, si gjendje *cash*. Fakti që pasuria është shitur më 18.7.2005 dhe investimi është kryer më 15.2.2007, tregon që ka kaluar një kohë e gjatë mes dy veprimeve, arsye kjo që e bind trupin gjykues që subjekti i rivlerësimit nuk mund ta ketë disponuar shumën e pretenduar. Për pasojë, balanca mbetet e pandryshueshme, e cila në vlerësimin tërësor të kësaj çështjeje nuk ndikon në vendimmarrjen për subjektin e rivlerësimit për ta penalizuar atë në kuadër të këtij procesi.

4.18 Ndërsa në lidhje me konstatimin e Komisionit se nuk justifikohet veprimi financiar i shitjes së apartamentit (nënës), blerë në vlerën 1.950.000 lekë (viti 2004) dhe shitur në vlerën 6.500.000 lekë (viti 2005), trupi gjykues fillimisht nuk synoi të përjashtojë vullnetin e palëve kontraktore pasi është e drejta e tyre, për më tepër kur ndodhet përpara tjetërsimit të pasurisë në favor të blerësit (nënës së subjektit), pra regjistrimit të saj sipas të gjitha kritereve ligjore pranë institucionit përkatës, por kërkoi shpjegime më të qarta lidhur me këtë shitblerje duke

qenë se palët karakterizohen nga një marrëdhënie familjare. Trupi gjykues, në kontekstin e shpjegimeve të dhëna nga subjekti se vlera e apartamentit (si rregull) do të rritej me kohën, se nëna e saj në cilësinë e blerëses ishte kujdesur të mos dëmtonte dhe të mos zhvlerësonte pasurinë apo edhe interesat pasurore të vajzës së saj, vlerëson se në këtë rast marrëdhënia kontraktore nuk është karakterizuar nga marrëdhënia familjare, por është çmuar dhe vlerësuar në kontekstin e dy palëve kontraktore të thjeshta, të cilat në themel kanë pasur vlerësimin real të pasurisë. Në këto kushte nuk diktohet ndonjë problematikë në shitblerjen e kësaj pasurie as sa i përket marrëdhënies kontraktore, por as edhe ligjshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave.

4.18.i Po ashtu, në vlerësim të dokumentacionit të administruar për regjistrimin e kësaj pasurie, trupi gjykues, nga vërtetimi i hipotekimit, lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë, në datë 4.10.2005, konstatoi se pasuria kishte kaluar në favor të nënës së subjektit të rivlerësimit, pra që me shitjen e saj. Gjithashtu, trupi gjykues, lidhur me këtë pasuri, nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje, ka konstatuar se kjo pasuri është rivlerësuar dhe me mandatpagesën datë 20.10.2016, të “Credins Bank”, ku janë kryer veprimet financiare për procedurën e rivlerësimit. Gjithashtu, kjo pasuri konfirmohet në emër të nënës së subjektit me certifikatën e pronësisë, datë 25.10.2016. Në këto kushte, qartazi provohet pagesa e çdo detyrimi tatimor për sa kohë institucioni përgjegjës ka regjistruar pasurinë në emër të blerësit dhe njëkohësisht ka lëshuar aktet që provojnë zotëruesin e pronës.

4.19 Njëkohësisht, Komisioni, me të drejtën që i njeh ligji dhe ushtrimi i kompetencave për të kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime edhe lidhur me të ardhurat e përfituara në shtetin italian, të cilat kanë shërbyer si burim krijimi për blerjen e apartamentit në Tiranë (më tej i shitur nënës), në shumën 1.900.000 lekë, megjithëse Komisioni në vijueshmërinë e hetimit mbajti në vëmendje periudhën e krijimit të pasurisë që në këtë rast daton përpara se subjekti i rivlerësimit të niste ushtrimin e detyrës dhe, për rrjedhojë, as edhe nuk ishte bërë subjekt deklarues.

4.19.i Subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara lidhur me këtë çështje. Ndër të tjera ka sqaruar se teksta studionte në periudhën 1999 – 2002 në “Universita ****”, kishte punuar gjatë fundjavave duke asistuar zonja të cilat ishin në moshë të thyer, mbi 80 vjeçe, si dhe ka konfirmuar se edhe pagesat ishin kryer *cash* çdo fundjavë. Subjekti ka deklaruar se për faktin se qëllimi i lejes së qëndrimit kishte qenë për studim nuk mund të kishte pasur një kontratë të rregullt pune. Për të provuar shkollimin dhe punësimin e saj (megjithëse në një moshë tepër të re 20 - 23 vjeçe) ka depozituar: një kopje të një blloku me shënime personale, të mbajtura prej saj në vitet 1999 – 2002, për të cilin sqaron se në faqet e të tij, ndër të tjera, rezultojnë edhe disa nga emrat, adresat dhe numrat e telefonit të personave pranë të cilëve ka punuar në atë kohë; kopje të *e-mail*-it të nisur prej saj në datën 20.1.2021, në adresën elektronike të universitetit “U. ****”; kopje të “Permesso di Soggiorno per stranieri” lëshuar më 21.5.2002; kopjen e librezës së studentit, lëshuar më 16.12.1999, Universita ***, me numër matriculimi ***; si dhe vërtetimin e regjistrimit, lëshuar nga sekretaria pranë “Universita ****” në datën 13.5.2002. Subjekti ka sqaruar se e ka objektivisht të pamundur për të disponuar dokumentacion lidhur me të ardhurat financiare që ka deklaruar në deklaratën *Vetting* për shkaqe të cilat nuk varen prej saj dhe në këtë kontekst ka kërkuar të vlerësohet pozita e saj në kuadër të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

4.19.ii Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, e vlerëson këtë çështje nën dritën e objektivitetit për shkak se ekzistojnë fakte dhe rrethana, të cilat nuk mund të rëndojnë pozitivisht e subjektit për të provuar ligjshmërinë e kësaj pasurie. Ndër të tjera, disa prej arsyeve që renditen nën këtë kontekst janë faktet se: (i) të ardhurat nuk janë krijuar dhe as nuk lidhen me periudhën e rivlerësimit kalimtar 2006 – 2016 (periudha e ushtrimit të detyrës së gjyqtarit), pra nuk kanë të bëjnë me periudhën e ushtrimit të detyrës së gjyqtarit; dhe se (ii) subjekti i rivlerësimit dukshëm ndodhet në pamundësi objektive sipas pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, për të disponuar dokumentacionin ligjor që lidhet me krijimin e këtyre të ardhurave

përgjatë periudhës 1999 – 2002, për shkaqe që nuk varen prej saj, pasi jo vetëm se ka kaluar një kohë e gjatë, rreth 20 vjet më parë, kohë në të cilën subjekti nuk mbartte detyrim ligjor të deklaronte pasurinë, por edhe se bëhet bindëse mospasja e një kontrate të rregullt pune (ndërsa subjekti ka qenë 23 vjeç), veprim i ndaluar nga qëllimi i lejes së qëndrimit për të cilin subjekti ndodhej në shtetin italian, për studime.

4.19.iii Në këtë logjikë arsyetimi, trupi gjykues çmon se rrethanat e parashtruara më sipër vlerësohen të tilla që nuk mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin për veprime të kryera para fillimit të detyrës së gjyqtarit.

5. Gjendja në llogarinë personale të znj. Migena Laska, në “Raiffeisen Bank”, aktualisht është: Ilogaria në euro = 554.52 euro me pjesë takuese: 100 %; Ilogaria në lekë = 44.42 lekë, me pjesë takuese: 100 %; Ilogaria në lekë = 344.89 lekë, me pjesë takuese: 100 %.

5.i “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 24.8.2020, informon se znj. Migena Laska ka llogaritë me gjendje në datën 24.1.2017, përkatësisht: Ilogaria në euro = 554.52 euro; Ilogaria në lekë = 44.42 lekë dhe Ilogaria në lekë = 344.89 lekë.

5.1 Trupi gjykues, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, konstatoi se subjekti ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këto llogari bankare

6. Gjendja në llogarinë personale të znj. Migena Laskaj, në Bankën Kombëtare Tregtare, aktualisht është: Ilogaria në lekë = 307.19 lekë. Pjesa takuese: 100%.

6.i BKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 21.8.202, informon se znj. Migena Laska ka llogari me gjendje 307.19 lekë në datën 24.1.2017

6.1 Trupi gjykues, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, konstatoi se subjekti ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë llogari bankare

7. Apartament i porositur me kontratë sipërmarrjeje, datë 13.11.2014, me sipërfaqe totale 79.16 m², 2+1 Zona ***, ap. ***, pranë fshatit turistik “****”, në L. . Sipërmarrës është shoqëria “****” sh.p.k. ndërsa porositësit M. N. dhe Migena Laska, me pjesë takuese nga 50% (në bashkëpronësi). Kontrata është lidhur në vitin 2014 pranë noteres publike E.T. . Vlera totale e objektit të porositur është 40.000 euro (bazuar në kontratën e sipërmarrjes së lidhur midis palëve). Më vitin 2014 është paguar nga z. M. N., në formën e këstit të parë, shuma 15.000 euro dhe në datën 3.9.2015 është kryer pagesa e këstit të dytë në shumën 10.000 euro, në lidhje me këtë kontratë porosie. Detyrimi i mbetur (për t’u paguar) është në shumën 15.000 euro. Kjo pagesë është kryer nga znj. Migena Laska me burim financiar:

1. pakësimi i gjendjes se deklaruar *cash* në shumën 867.700 lekë (burimi: kursimi, ndër vite, nga rroga si gjyqtare, si dhe nga interesat e bonove të thesarit të deklaruar vijueshmërisht, në cilësinë e subjektit për llogari të ligjit për “Deklarimin edhe kontrollin e pasurive dhe parandalimin e konfliktit të interesave” pranë ILDKPKI-së, prej 10 vjetësh);
2. kursimet vjetore (përgjatë vitit përkatës) në vlerën 400.000 lekë;
3. interesat e bonove (për gjatë viti përkatës) në vlerën 132.300 lekë (të dhëna të detajuara këto në deklaratimet periodike të subjektit, konkretisht edhe në atë të vitit 2015).

7.1 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në DPV-në e vitit 2014 (në rubrikën e të dhënave konfidenciale) me përshkrimin: “Lidhur një kontratë sipërmarrjeje, ku është porositur një shtëpi/apartament me sip. 80 m² në total, në L., pranë fshatit turistik ‘***’. Sipërmarrësi është subjekti ‘****’ sh.p.k., ndërsa porositësit M. N. 50% dhe Migena Laska 50% (në bashkëpronësi). Është paguar nga ana e M. N. në vitin 2014, në formën e këstit të parë shuma prej 15.000 euro”. Kontratë noteriale nr. ***, datë 13.11.2014, lidhur para noteres publike E.T. .

7.2 Në DPV-në e vitit 2015 (në rubrikën e detyrimeve financiare), subjekti deklaroi se: “Në datën 3.9.2015 është kryer pagesa e këstit të dytë, në lidhje me kontratën e porosisë së lidhur me shoqërinë ‘****’ sh.p.k. në vitin 2014, për ndërtimin e një apartamenti”. Kjo pagesë është kryer nga znj. Migena Laska me burim financiar:

- pakësimi i gjendjes *cash* në shumën 867.700 lekë;
- kursimet vjetore në shumën 400.000 lekë;
- interes të bonove në shumën 132.300 lekë.

Totali: në shumën 1.400.000 lekë, konvertuar me kursin e kohës në 10.000 euro dhe detyrimi i pa shlyer në shumën 15.000 euro.

7.3 Për këtë pasuri subjekti ka depozituar³¹: (i) kontratë sipërmarrjeje nr***, datë 13.11.2014, me palë sipërmarrëse shoqërinë tregtare “****” sh.p.k. dhe palë porositëse Migena Laska dhe M. N., ku është porositur një apartament i tipit 2+1, i cili ndodhet në Zonën *** me nr. 3, me sipërfaqe ndërtimi 79.16 m², në vlerën 40.000 euro – kësti i parë do të jetë *cash* me lidhjen e kontratës në masën 15.000 euro dhe diferenca do të paguhet me pjesë deri në përfundimin e punimeve; (ii) ditar klienti, nga shoqëria “****” sh.p.k., ku në datë 11.11.2014, është paguar shuma 15.000 euro nga M.N. dhe Migena Laska; (iii) mandatarkëtimi, datë 3.9.2015, i shumës 10.000 euro me arkëtues Migena Laska dhe M. N. (pagesë kësti i dytë të apartamentit te ***).

Hetimi i kryer nga Komisioni

7.4 Në kontratën e porosisë vlera e apartamentit është 40.000 euro, sipas së cilës parashikimi për pagesat ka qenë, si më poshtë:

- kësti i parë do të jetë *cash* me lidhjen e kontratës në masën prej 15.000 euro; dhe
- diferenca do të paguhet me pjesë deri në përfundimin e punimeve.

7.5 Në dokumentacionin e depozituar³² nga shoqëria “****” sh.p.k., evidentohet se këstet e apartamentit janë paguar me anë të mandatarkëtimin datë 11.11.2014, vlera 15.000 euro dhe mandatarkëtimin nr. ***, datë 3.9.2015, vlera 10.000 euro.

7.6 Meqenëse kësti i parë, në shumën 15.000 euro, i kësaj kontrate porosisë është paguar nga bashkëjetuesi, Komisioni, lidhur me pasuritë e tij, është shprehur në seksionin e deklaratimit të bashkëjetuesit, në pikën 17 të këtij vendimi.

7.7 Për këtë pasuri, subjekti rivlerësimit ka paguar vetëm një këst në shumën 10.000 euro ose 1.400.000 lekë. Si burim krijimi për këtë pagesë subjekti ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash*, kursimet vjetore, si dhe interesat e bonove.

7.8 Komisioni kreu analizën financiare, me burimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, në datën kur është kryer pagesa.

- ✓ Trupi gjykues, nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, konstatoi se subjekti ka pasur mundësi financiare të kryejë pagesën e këstit të dytë, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

7.9 Në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit

Komisioni ka mbajtur korrespondencë³³ edhe me institucionet punëdhënëse të subjektit të rivlerësimit, të cilat në përgjigjet³⁴ e tyre, në asnjë rast nuk konfirmuan zhvillimin e ndonjë procesi gjyqësor me palë ndërgjyqëse shoqërinë “****” sh.p.k., apo administratorin e saj.

Në të tilla kushte, trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë problematikë lidhur me këtë çështje.

7.10 Po ashtu, Komisioni hetoi edhe në lidhje me ndonjë trajtim preferencial të mundshëm në përfitimin e kësaj pasurie, nga ku nuk evidentoi ndonjë problematikë të vlerësuar nën këtë kontekst.

7.11 Edhe pse subjekti i rivlerësimit dhe bashkëjetuesi, deri në momentin e depozitimit të deklaratës *Vetting*, kishin paguar vetëm dy këstet e para të kësaj kontrate porosisë, Komisioni e

³¹Aneks nr. 4/6, në dosjen e ILDKPKI-së.

³²Aneks nr. 36, në dosjen e ILDKPKI-së.

³³Kërkesë nr. *** prot., datë 24.2.2021, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

³⁴Shkresë nr. *** prot., datë 5.3.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresë nr***prot., datë 2.3.2021, nga Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

shtriu hetimin edhe më tej kësaj periudhe për këtë pasuri. Gjatë hetimit ka rezultuar se kontrata e sipërmarrjes është likuiduar si më poshtë:

Tabela nr. 3

Datë	Shuma në euro	Emri personit	Dokumentacioni
11.11.2014	15,000	M. N.	Mandatarkëtim
3.9.2015	10,000	Migena Laska	Mandatarkëtim
20.11.2019	18,660	M. N.	Transferte bankare nga "Credins Bank"
TOTAL	43,660		

7.12 U vërejt se shuma e paguar ishte në vlerën 43.660 euro, pra, më e lartë sesa vlera e kontratës së sipërmarrjes dhe, për këtë shkak, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime.

7.13 Subjekti, ndër të tjera, në prapësime ka shpjeguar se kjo mund të ketë ardhur si pasojë e disa shpenzimeve shtesë të kryera nga shoqëria sipërmarrëse, deri në momentin e likuidimit të plotë të detyrimit të kësaj kontrate (*sikurse mund të jenë p.sh., shpenzime për procedura të ndryshme ligjore, shpenzime noteriale, pagesa mirëmbajtje, e të tjera si këto*), të cilat në momentin e likuidimit të plotë dhe përfundimtar të kësaj kontrate i janë listuar dhe komunikuar zyrtarisht z. M. N. . Ky i fundit i ka marrë përsipër që t'i kryejë, duke përmbushur kështu çdo detyrim financiar kundrejt shoqërisë ndërtuese "****" sh.p.k., lidhur me këtë kontratë sipërmarrjeje. Të gjitha veprimet financiare janë kryer në transaksion bankar ose me mandatarkëtim. Pagesat e fundit janë likuiduar nga z. M.N., në nëntor të vitit 2019, nëpërmjet transaksionit bankar në "Credins Bank". Gjithë dokumentacionin përkatës shoqërues e ka paraqitur në mënyrë kronologjike, bashkëngjitur deklarimeve periodike, deklaratës *Vetting*, pyetësorëve nr. 2, 3 dhe 4, në kuadër të këtij hetimi administrativ.

7.14 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna, i çmon bindëse argumentet e prezantuara nga subjekti, duke vlerësuar, gjithashtu, në këtë kontekst edhe faktin se veprimet financiare janë kryer nga bashkëjetuesi në rrugë bankare apo me mandatpagesa, por edhe se është provuar mundësia financiare e tij në çdo rast të investimeve të kryera. Në rast të një situatë të paparashikuar në porositjen e një pasurie, sikurse mund të ketë ndodhur në konstatimin e shpenzimeve të tjera të vlerësuara nga shoqëria ndërtimore, përtej atyre të parashikuara në fillim të marrëdhënies kontraktore, kur palët gjejnë zgjidhje me vullnetin e tyre, ajo që mbetet për shkak të këtij hetimi është thjesht dhe vetëm fakti i provueshmërisë së burimit të shumëk ekstra të dhënë në favor të shoqërisë, që në këtë rast është 3.000 euro. Trupi gjykues, rast pas rasti, në këtë arsyetim është shprehur lidhur me mundësinë financiare të bashkëjetuesit të subjektit, që edhe në këtë çështje merr të njëjtin vlerësim, pasi ka qenë në vazhdimësi në pozita financiare të mjaftueshme për të kontribuar në krijimin e pasurive.

7.15 Në vijim, po lidhur me këtë pasuri, është konstatuar se janë kryer disa veprime për periudhën 2017 – 2019:

- në deklaratën periodike të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka financuar shumën 3.500.000 lekë për të përballuar shpenzimet e kryera në apartamentin 2+1 në fshatin turistik "****", në ***;
- në deklaratën periodike vjetore të vitit 2019, subjekti deklaroi se është tërhequr nga pjesa takuese, në investimin e kryer për apartamentin 2+1, të ndodhur në ***. Për këtë është hartuar edhe aktmarrëveshja nr. ***, datë 21.11.2019, me palë shtetasit M. N. dhe Migena Laska, sipas së cilës shuma totale e investuar prej subjektit të rivlerësimit në këtë pasuri është 36.000 euro dhe në datën 21.11.2019 është likuiduar vlera 30.000 euro prej z. M.N. në llogarinë e saj bankare në "Credins Bank". Detyrimi i pashlyer nga z. M.N. është në vlerën 6.000 euro.

Pas hartimit të aktmarrëveshjes për tërheqjen nga investimi të subjektit Migena Laska, z. M. N. e ka shkëmbyer këtë pasuri, pas një jave, me disa pasuri të shtetases Sh.A. . Palët kanë hartuar kontratë zëvendësimi dhe kalim të drejtash nr. ***, datë 27.11.2019, me palë shoqërinë “***” sh.p.k. – Sh. A. – M. N. . Janë tri palë në këtë kontratë për shkak të mënyrës së përfitimit të pasurive prej shtetases Sh. A. . Apartamenti 2+1, në ***, është shkëmbyer me pasuritë e ndodhura në rrugën “M. D.”, në kryqëzim me rrugën “***”, Tiranë, përkatësisht: (i) apartament me sip. 122.17 m², nr. ***, kati ***; (ii) vendparkim nr***, kati (***); (iii) vendparkimi nr. ***, kati (***); (iv) depo me sip. 20.5 m², nr. ***, kati (***).

7.16 Komisioni duke marrë në konsideratë:

- vlerën 40.000 euro të deklaruar për apartamentin me sip. 79.16 m², në kompleksin turistik “***”, në ***;
- vlerën e paguar në total prej 43.660 euro;
- verën totale prej 69.660 euro, si shumë e paguar për blerjen e apartamentit dhe shpenzimet e kryera; si dhe
- pasuritë me të cilat është shkëmbyer (apartament me sip. 122.17 m², dy vendparkime dhe depo me sip. 20.5 m²),

ngriti dyshime për vlerën reale të pasurive të shkëmbyera, edhe për faktin se pasuritë në Tiranë ndodhen në një zonë ku çmimi³⁵ për metra katrorë është relativisht i lartë në krahasim me zonat e tjera. Subjekti, pasi është pyetur, ka deklaruar se këto veprime janë vullnet i palëve kontraktore.

7.17 Trupi gjykues, në vlerësim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti për shkëmbimin e pasurive, por edhe për të provuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve, arsyeton si vijon:

7.17.i Një aspekt i rëndësishëm për t’u vlerësuar, i cili nuk është rezultat i prapësimeve, është fakti i konstatuar më herët se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëjetuesi e kanë deklaruar me saktësi, që në deklarinë periodik të vitit 2014 kontratën noteriale të sipërmarrjes, për porositjen e apartamentit me sip. 79 m², në ***, nënshkruar në nëntor të vitit 2014 me shoqërinë ndërtuese “***” sh.p.k.

7.17.ii Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëjetuesi në të gjitha deklarinët e tyre periodike nga viti 2014 e në vijim, sikurse edhe në deklarinë *Vetting*, kanë deklaruar çdo pagesë dhe investim të kryer nga secili prej tyre, lidhur me këtë apartament.

7.17.iii Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëjetuesi kanë pasur mundësi financiare që të përballojnë këstet e pagesave të kryera lidhur me këtë apartament, që nga viti 2014 dhe në vijim.

7.17.iv Gjithashtu, nga hetimi nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të kishte ndonjë “konflikt interesi” me shoqërinë sipërmarrëse/ndërtuese dhe as të ishte trajtuar në mënyrë preferenciale në çmimin e kësaj porositje.

7.17.v Vlera e kontratës së sipërmarrjes rezultoi e likuiduar plotësisht, duke përmbushur kështu çdo detyrim financiar kundrejt shoqërisë ndërtuese “***” sh.p.k.

7.17.vi Të gjitha veprimet financiare, gjithashtu, rezultuan të kryera me transaksion bankar ose me mandatarkëtime të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në Komision, në kuadër të këtij hetimi administrativ.

7.17.vii Vlera e apartamentit të kontraktuar në vitin 2014, me kontratë sipërmarrjeje në ***, ka rezultuar jo vetëm vlera e çmimit të blerjes 40.000 euro (rreth 500 euro/m²), por kësaj shume i shtohet edhe vlera e mobilimit të këtij apartamenti = 3.500.000 lekë³⁶, pra, në total në vlerën 66.000 euro. Të gjitha këto veprime u konstatuan të deklaruara nga subjekti dhe personi i lidhur

³⁵Sipas VKM-së nr. 168, datë 27.3.2019, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 132, datë 7.3.2018”, të Këshillit të Ministrave, “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

³⁶Vlerë mobilimi e deklaruar në deklarinë periodik të vitit 2017.

në DVP-të përkatëse dorëzuar në ILDKPKI, bazuar në dokumentacionin ligjor mbështetës, të administruar edhe në kuadër të këtij hetimi administrativ.

7.17.viii Subjekti i rivlerësimit, vlerën reale të investuar në apartamentin në *** (10.000 euro + 3.500.000 lekë³⁷) e ka marrë totalisht nëpërmjet kalimit bankar të kryer nga z. M.N. (bashkëjetuesi), në këmbim të heqjes dorë nga çdo e drejtë reale mbi këtë pronë/apartament, bazuar kjo në aktmarrëveshjen noteriale të datës 21.11.2019³⁸.

7.17.ix Shuma totale prej 36.000 euro, e cila përkon me investimin real të bërë nga subjekti i rivlerësimit në apartamentin në ***, i është kaluar subjektit të rivlerësimit në llogarinë bankare në “Credins Bank” nga bashkëjetuesi M. N., kjo deklaruar në DPV-në e vitit 2019, si dhe bazuar në vërtetimin nga “Credins Bank” të datës 6.4.2021.

7.17.x Bazuar në kontratat noteriale të kryera në datat 21.12.2019 dhe 27.12.2019³⁹, lidhur ndërmjet z. M. N. (personi i lidhur/bashkëjetuesi i subjektit) dhe znj. Sh. A., bazuar në një marrëveshje të lirë dhe të vullnetshme mes palëve kontraktuese, nënshkruar dhe vërtetuar para noterit publik (materializuar në kontratat noteriale respektive), është dakordësuar shkëmbimi i të drejtave reale të pronësisë, ndërmjet apartamentit në ***, si dhe pronës që dispononte me të drejta reale pronësie znj. Sh.A., bazuar në një kontratë porosie (të disponuar më parë prej saj).

7.17.xi Subjekti i rivlerësimit, sikurse u citua edhe më sipër, pas gjithë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni: (i) nuk ka rezultuar në asnjë rrethanë në konflikt interesi me asnjërën prej palëve kontraktore të mësipërme; (ii) nuk është palë kontraktore apo përfituese në këtë marrëdhënie shkëmbimi të drejtash reale; (iii) nuk tërheq asnjë interes pasuror nga ky shkëmbim; (iv) nuk është firmëtare e këtyre kontratave të shkëmbimit; si dhe (v) nuk rezulton të ketë shprehur asnjë formë vullneti lidhur me këtë shkëmbim, pasi nuk disponon të drejta dhe detyrime ligjore mbi të.

7.17.xii Në përfundim të kësaj analize, trupi gjykues në shqyrtim të plotë të të gjitha fakteve, provave dhe rrethanave konkrete, nuk konstatoi ndonjë problematikë në kuadër të marrëdhënieve kontraktore të shkëmbimit të këtyre pronave.

Detyrimet financiare

8. Pagaru këstin e parë të regjistrimit në “**”, për vitin e parë akademik 2016 – 2017, në planin studimor *Bachelor*, për djalin Ch. R.L. . Shuma e paguar në datën 20.9.2016 është 130.273.50 lekë. Burimi: kursimet vjetore, nga paga si gjyqtare gjatë vitit 2016. Shuma e mbetur për t’u paguar, në lidhje me këstin e dytë, i cili paguhet në mars – prill 2017 është 925 euro.**

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

8.1 Subjekti deklaroi në deklaratën periodike të vitit 2016 se ka paguar këstin e parë të regjistrimit në “****”, për vitin e parë akademik 2016 – 2017, në planin studimor *Bachelor*, për djalin Ch.R.L.. Shuma e paguar në datën 20.9.2016 është 130.273,5 lekë me burim nga kursimet vjetore nga paga si gjyqtare gjatë vitit 2016.

8.2 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka depozituar⁴⁰ dokument për aplikim/regjistrim në “****” për djalin Ch. R. L., si dhe kuponin e pagesës në shumën 130.273.50 lekë, në datën 20.9.2016.

8.3 Ndërsa në pyetësorin standard, subjekti ka depozituar kontratën e studimit të datës 20.9.2016, me “****”, në të cilën është përcaktuar tarifa vjetore në shumën 1.875 euro, e cila paguhet në dy këste të barabarta prej 937.5 euro për secilin semestër (vjeshtë, pranverë).

³⁷Deklaruar periodikisht në DPV në ILDKPKI.

³⁸Depozituar nga subjekti.

³⁹Dokumentacioni ligjor mbështetës është depozituar nga subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorëve nr. 2 dhe 3, në shpjegimet e dorëzuara në datën 6.5.2021, si dhe në shpjegimet e dorëzuara në datën 12.5.2021, në kuadër të këtij hetimi administrativ.

⁴⁰Aneks nr. 4/8 në dosjen e ILDKPKI-së.

- ✓ Trupi gjykues, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, vërejtji se konfirmohet deklarimi i subjektit për këtë detyrim financiar.

9. Apartament i porositur me kontratë sipërmarrjeje, datë 13.11.2014, me sipërfaqe totale 79.16 m², 2+1, Zona ***, ap. ***, pranë fshatit turistik “****”, në ***. Sipërmarrësi është shoqëria “****” sh.p.k., ndërsa porositësit M.N. dhe Migena Laska, me pjesë takuese nga 50% (në bashkëpronësi). Vlera totale e objektit të porositur është 40.000 euro (bazuar në kontratën e sipërmarrjes së lidhur midis palëve). Nga z. M. N. është paguar në vitin 2014, në formën e kështit të parë shuma 15.000 euro. Në datën 3.9.2015 është kryer pagesa e kështit të dytë në shumën 10.000 euro në lidhje me këtë kontratë porosie, pagesë e kryer nga znj. Migena Laska. Detyrimi i mbetur për t’u paguar është në vlerën 15.000 euro.

9.1 Komisioni e ka trajtuar këtë pasuri në pikën nr. 7 të këtyre rezultateve. Në bazë të deklarimeve periodike të subjektit dhe akteve të administruara, vlera e kësaj pasurie është 40.000 euro. Shtetasi M. N. (bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit) ka paguar kështin e parë në vitin 2014, në shumën 15.000 euro, ndërsa subjekti ka paguar kështin e dytë në vitin 2015, në shumën 10.000 euro. Detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., rezulton të jetë në vlerën 15.000 euro. Në pikën 7.11 të trajtuar në këto rezultate është evidentuar se bashkëjetuesi i subjektit ka paguar vlerën 18.660 euro në vitin 2019 dhe jo vlerën e deklaruar prej 15.000 euro sipas kontratës së porosisë.

- ✓ Trupi gjykues e ka trajtuar, ka arsyetuar dhe konkluduar për këtë çështje në pikën 7, më sipër.

Deklarimi i pasurive të bashkëjetuesit të subjektit – z. M. N.

10. Apartament 2+1, në pronësi personale, bazuar në vërtetimin hipotekor të pronësisë nr. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***.

Garazh, bazuar në kontratën nr****, datë 20.2.2012, kryer para noteres publike N.K. . Burimi i krijimit: të ardhurat nga puna, ndër vite, si gazetar, që prej vitit 1997. Vlera: 23.000 euro. Pjesa takuese: 100%.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

10.1 Subjekti i rivlerësimit e deklaroi për herë të parë bashkëjetuesin në deklaratën periodike të vitit 2014.

10.2 Në deklaratën e interesave private të personit të lidhur për vitin 2014, shtetasi M. N. ka deklaruar se disponon pasuri veçmas në emrin e tij.

10.3 Këtë pasuri e deklaroi me përshkrimin: “*Apartament 2+1, bazuar në vërtetimin hipotekor të pronësisë, nr. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k****dhe kontratë shitblerje nr. ***, datë 20.2.2012. Vlera: 23.000 euro. Garazh, bazuar në kontratën nr. ***, datë 20.2.2012, kryer para noteres publike N. K.*”.

10.4 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka depozituar⁴¹ kontratën e shitblerjes për apartamentin dhe garazhin, si dhe njoftim debitimin nga “Raiffeisen Bank”, datë 13.2.2012, të shumës 23.000 euro nga z. M. N. me përshkrimin “likuidim për blerje apartamenti”, klienti përfitues shoqëria “****” sh.p.k..

Hetimi i kryer nga Komisioni

10.5 ASHK - Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 2, me shkresën nr. *** prot., datë 8.9.2020, informon se për sa i përket pasurive të tjetërsuara në emër të shtetasit M. N., figurojnë të regjistruara pasuri të tjetërsuara, si më poshtë:

- garazh me sip. 35.4 m², z. k. ***, vol. ***, f. ***, pasuri e transkriptuar;
- apartament me sip.73.9 m², z. k. ***, vol. ***, f. ***, pasuri e transkriptuar.

⁴¹Aneks nr.4/9 në dosjen e ILDKPKI-së.

10.6 Nga dokumentacioni shoqërues i përcjellë nga kjo drejtori, vihet re se pasuria apartament + garazh i është shitur shtetas E. C. me kontratën nr. ***, datë 13.12.2017. Çmimi i shitjes është në vlerën 33.000 euro për apartamentin dhe në vlerën 11.000 euro për garazhin, pra, në total në vlerën 44.000 euro.

10.7 Me pyetësin⁴² nr. 2, subjekti ka depozituar: (i) dy kontratat e shitjes me shoqërinë “****” sh.p.k., për blerjen e apartamentit dhe garazhin; (ii) transfertën bankare të datës 13.2.2012, përkatësisht: shumën 23.000 euro për shoqërinë “****” sh.p.k. dhe shumën 14.000 euro për shtetasin I. A. Sh. (administrator i shoqërisë “****” sh.p.k).

10.8 Nga dokumentacioni rezulton se për këto dy pasuri (apartament+garazh) është paguar vlera 37.000 euro. Kjo vlerë nuk përputhet me asnjë nga deklaratimet e kryera nga bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit. Vihet re që ka mospërputhje mes vlerës me shifra 23.000 euro në deklaratën periodike vjetore 2014 dhe në deklaratën *Vetting* dhe të asaj me fjalë *dyzet e një mijë euro* në deklaratën periodike vjetore 2014 dhe *dyzet e tre mijë euro* në deklaratën *Vetting*.

10.9 Sipas projekt marrëveshjes nr. ***, datë 17.9.2012, pasuria apartament me sip. 73.9 m² i është nënshtruar pjesëtimit të pasurive të krijuara gjatë martesës dhe, për pasojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë nuk mund t’i nënshtrohet analizës financiare të subjektit të rivlerësimit, pasi është krijuar në një marrëdhënie tjetër familjare me të ardhura të cilat, gjithashtu, kanë buruar nga ajo marrëdhënie. Pra, në tërësi kjo pasuri nuk afekton subjektin e rivlerësimit dhe as nuk mund të rëndojë pozitën e tij në këtë hetim administrativ. Për më tepër, trupi gjykues ka qartësuar dhe ezauruar mjaftueshëm pozitën e bashkëjetuesit të subjektit në raport me këtë pasuri dhe jo vetëm në trajtimin që ka bërë më sipër, lidhur me ligjshmërinë e shumës 24.000 euro dhuruar subjektit të rivlerësimit në vitin 2014, kohë në të cilën subjekti dhe bashkëjetuesi kanë nisur marrëdhënien e tyre të bashkëjetesës.

11. Kursime cash në vlerën 400.000 lekë, krijuar nga të ardhurat, ndër vite (të përfituara), nga puna sistematike e vazhdueshme e përditshme: (i) si gazetar/analist/opinionist, pranë mediave të shkruara dhe vizive (emisione televizive, i ftuar si moderator, si dhe shkrime/opinione në gazeta të përditshme shqiptare si p.sh. “Top Channel”, “Ora News”, si dhe në gazetat “Shekulli”, “Shqip”, “Korrieri”, “Dita”, “Mapo”, etj., që prej vitit 1997, e në vijueshmëri; (ii) moderator i emisioneve televizive: në periudhën 2007 – 2010 “Deja vu”, në “Top Channel”; në periudhën 2012 – 2014 “Jamais vu” pranë televizionit “Ora News”; (iii) autor i disa librave të botuar, ndër vite, si “****” në vitin 2002, sponsorizuar nga Fondacioni “****”: www.Shqiperiadheynë.com në vitin 2004; “Hinterland i kuq” në vitin 2009; “Unë jam Gege” në shtator 2013; “Pax Albanica” në shtator 2014; “Selam Ailekum Baba” botuar në 2016. “Çmimi libri më i mirë vitit 2015” me librin “Pax Albanica”, me autor M. N. fituar çmimi “Ardian Klosi” në panairin kombëtar të librit në Tiranë sponsorizuar nga “T.”, depozituar në llogarinë bankare në euro në “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 21.10.2015. Një pjesë e këtyre të ardhurave financiare janë tërhequr në rrugë bankare, bazuar kjo dhe në statementin që disponon, por një pjesë e tyre, për arsye krejtësisht objektive janë tërhequr në gjendje *cash*, situatë e cila ka funksionuar në gjendje, ndër vite, në shumë marrëdhënie pune në media të shkruara dhe audiovizive. Pjesën formale të të dhënave që personalisht mundet dhe arrin ta disponojë e vë haptazi në dispozicion.

- Të gjitha këto, janë fakte të ditura e të njohura publikisht dhe mediatikisht (në shtypin e shkruar dhe atë audiovizive). Pjesa takuese: 100%.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

11.1 Bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit, nga deklarimi për herë të parë në vitin 2014 e në vazhdim, ka deklaruar kursime (shtesa dhe pakësime) *cash*.

11.2 Komisioni nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor kreu analizën në datën 24.1.2017 me gjendjen *cash* të deklaruar dhe nuk i rezultuan problematika.

⁴²Datë 20.1.2021.

Bashkëjetuesi i subjektit, gjithashtu, ka deklaruar gjendje në llogari të ndryshme bankare si vijon:

12. Gjendje në llogari rrjedhëse, në euro në “Credins Bank”, deri në datën 20.1.2017, në vlerën 6,04 euro.

13. Gjendje në llogari rrjedhëse, në lekë në “Intesa Sanpaolo Bank”, deri në datën 19.1.2017, në vlerën 135,68 lekë.

14. Gjendje në llogari rrjedhëse në lekë në “Intesa Sanpaolo Bank”, deri në datën 19.1.2017, në vlerën 5.551,73 lekë.

15. Gjendje në llogari rrjedhëse në euro në “Intesa Sanpaolo Bank”, deri në datën 19.1.2017, në vlerën 8.026,49 euro.

16. Gjendje në llogari personale në “Raiffeisen Bank”, deri në datën 20.1.2017, bazuar në statementin e lëshuar nga institucioni bankar, në vlerën 3.276,48 lekë.

✓ Në konkluzion, trupi gjykues, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, por dhe në analizë të secilit veprim financiar, konstatoi se bashkëjetuesi i subjektit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin llogaritë e tij bankare.

17. Apartament i porositur me kontratë sipërmarrje, me sipërfaqe totale 79.16 m², 2+1. Zona ***, ap. ***, pranë fshatit turistik “***”, në ***. Sipërmarrës është shoqëria “***” sh.p.k., ndërsa porositësit M.N. dhe Migena Laska, me pjesë takuese nga 50% (në bashkëpronësi). Kontrata është lidhur në vitin 2014 pranë noteres publike E. T. . Është paguar nga z. M.N. në vitin 2014, në formën e këstit të parë shuma 15.000 euro. Është paguar nga znj. Migena Laska në vitin 2015, kësti i dytë në shumën 10.000 euro, pra, totali i paguar është në shumën 25.000 euro. Vlera totale e objektit të porositur është 40.000 euro (bazuar në kontratën e sipërmarrjen së lidhur mes palëve) dhe detyrimi i mbetur pa shlyer është në shumën 15.000 euro. Burimi i krijimit të shumës së paguar nga ana ime (si më sipër shpjegohet) janë të ardhurat nga puna shumëvjeçare dhe e pandërprerë si gazetar (fakt i ditur botërisht).

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

17.1 Komisioni, lidhur me mënyrën e përfitimit dhe statusit aktual të kësaj pasurie, është shprehur, më sipër në pikën 7 të këtyre rezultateve. Në këtë pikë është kryer analiza financiare për këstin e parë prej 15.000 euro të paguar nga z. M.N. .

17.2 Komisioni ka kryer analizën financiare me të dhënat (të ardhura, shpenzime, pasuri), që ka administruar gjatë hetimit, për periudhën qershor 2007 – 2014. Edhe pse kësti i parë është paguar në nëntor të vitit 2014, analiza është kryer deri në fund të vitit, pasi Komisioni nuk mundi të evidentojë saktësisht gjendjen *cash* të akumuluar.

✓ Trupi gjykues, pasi kreu nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor analizën financiare, konstatoi se bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit ka pasur mundësi të investojë në këstin e parë të kësaj pasurie, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera.

Detyrimet financiare

18. Kontratë Leasing në “Credins Bank”

Blerë automjet tip “Passat Volkswagen”, me targa ***, bazuar në kontratën e tipit *Leasing* të lidhur në janar të vitit 2015 me “Credins Bank”. Çmimi i blerjes së automjetit 16.000 euro. Shuma e financimit nëpërmjet “Credins Bank” 10.000 euro. Parapagimi 6.472 euro. Këstet mujore 311,06 euro/muaj. Afati i shlyerjes 36 muaj. Data e përfundimit të kësaj kontrate më 22.1.2018. Deri më 31.12.2016 është likuiduar shuma 7.154 euro (të gjitha këto të dhëna të bazuara e të shoqëruara me vërtetimin nga “Credins Bank”). Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur pa shlyer, në vijim, është 4.043 euro.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

18.1 Bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit e deklaroi për herë të parë këtë investim në DPV-në e vitit 2015 me përshkrimin : “*Blerë automjet tip ‘Passat Volkswagen’, viti i prodhimit 2012, me targa ***, bazuar në kontratën e tipit Leasing të lidhur në janar të vitit 2015 me ‘Credins Bank’. Parapaguar 6.472 euro, e në vijueshmëri pagimi i kësteve mujore në shumën 311 euro/muaj*”.

18.2 Subjekti, së bashku me deklaratën *Vetting*, ka depozituar edhe dokumentacion mbështetës⁴³.

18.3 Nga korrespondenca e Komisionit me “Credins Bank” rezultoi se z. M. N. ka paguar: në datën 27.1.2015, vlerën 6.000 euro, parapagim për automjetin “Volkswagen Passat”; si dhe këstet e *Leasing* në vlerën 7.392,5 euro, për periudhën 2015 – 24.1.2017.

✓ Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar, konstatoi se bashkëjetuesi i subjektit ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi këtë pasuri.

19. Apartament i porositur me kontratë sipërmarrje datë 13.11.2014, me sipërfaqe totale 79.16 m², 2+1, Zona ***, ap. ***, pranë fshatit turistik “****”, në L. . Sipërmarrësi është subjekti “****” sh.p.k. ndërsa porositësit: M.N. dhe Migena Laska , me pjesë takuese nga 50% (në bashkëpronësi). Vlera totale e objektit të porositur është 40.000 euro (bazuar në kontratën e sipërmarrjes së lidhur midis palëve). Është paguar nga ana e z. M. N. në vitin 2014, në formën e këstit të parë shuma 15.000 euro. Në datën 3.9.2015 është kryer pagesa e këstit të dytë 10.000 euro në lidhje me këtë kontratë porosie. Kjo pagesë është kryer nga Migena Laska. Detyrimi i mbetur për t’u paguar është 15.000 euro.

✓ Trupi gjykues këtë pasuri e ka hetuar dhe trajtuar më sipër, në deklarin e pasurive të subjektit të rivlerësimit, pasi është investim i përbashkët dhe në përfundim nuk i kanë rezultuar problematika.

Në konkluzion për rivlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar me saktësi dhe vërtetësi pasuritë dhe burimin e krijimit të tyre dhe se konkludimi i arritur, në pikën 2.6 dhe 4.17 të këtij vendimi, proporcionalisht dhe objektivisht në tërësi të vlerësimit të këtij kriteri, nuk përbën shkak të mjaftueshëm për aplikimin e ndonjë mase disiplinore sipas parashikimeve të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, ndaj subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas germës “a”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (referuar si “**DSIK**”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte, nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar për subjektin e rivlerësimit, Raportin mbi kontrollin e figurës nr. ***, datë 2.11.2017, të deklasifikuar me vendim nr. ***, datë 30.4.2021, të KDZh-së. Edhe pas kërkesës për përditësim të Komisionit⁴⁴ nga institucionet ligjzbatuese, apo dhe hetimi i kryer, nuk u identifikuan të dhëna/*indicje* që mund të komprometonin figurën e subjektit të rivlerësimit.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Migena Laska.

Komisioni, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të

⁴³ Aneks nr.4/15 në dosjen e ILDKPKi-së

⁴⁴Referojuni dosjes së nivelit “sekret” të subjektit të rivlerësimit.

pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të rivlerësimit për kontrollin e figurës, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit Migena Laska arrin nivel të besueshëm, sipas parashikimit të gremës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklaratime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Analiza e gjetjeve

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; si dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore në KLGj-ja.

Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit Migena Laska ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, njeh parimet e përgjithshme të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i zbaton ato në praktikë, si dhe në tekstin e vendimeve përfundimtare. U konstatua se në funksion të zbatimit të ligjit subjekti përdor referenca nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës Kushtetuese, si dhe jurisprudencën e Gjykatës së Lartë. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, është konstatuar se përgjithësisht se identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në të gjitha çështjet penale të analizuar është konstatuar se vendimi gjyqësor përmban referenca ligjore, duke i kushtuar rëndësi të gjithë elementëve të veprës penale (shihni dokumentet 1, 2 e 3 dhe dosjet 1, 2, 3 e 4), si dhe arrin të analizojë shkaqet dhe rrethanat që çojnë në vendimin e prokurorit për mosfillimin e procedimit penal (shihni dosjen 5). Gjithashtu, rezulton se ka njohuri të mira të procedurave të gjykimit të çështjeve gjyqësore penale që ka shqyrtuar. Njeh aspektet e procesit të rregullt ligjor në drejtim të pjesëmarrjes së palëve në gjykim, të kontradiktoritetit dhe deri tek arsyetimi i vendimit gjyqësor. Natyra e çështjeve penale që subjekti ka shqyrtuar ka qenë e ndryshme dhe tregon gjerësinë e njohurive të saj të përfuara përmes përvojës në punë. Ndër tri dokumentet e përzgjedhura dhe pesë dosjet e vëzhguara, janë ankimuar 6 prej tyre. Në të gjitha këto raste, Gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit. Në dy rastet e tjera nuk është ushtruar ankim nga palët.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Migena Laska ka aftësi të mira në arsyetimin ligjor, vendimet gjyqësore të hartuara prej saj, janë të qarta dhe të kuptueshme, struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve gjyqtarja i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, e cila kur është rasti plotësohet edhe me pjesë nga jurisprudenca unifikuuese e Gjykatës Kushtetuese apo Gjykatës së Lartë.

Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nga tri dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara, janë ankimuar 6 prej tyre. Në të gjitha këto raste, Gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit. Në asnjë rast nuk është cenuar vendim për shkak të procesit të parregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në dispozitivin e vendimit, në rastet e vëzhguara, është konstatuar se gjithmonë disponohet për shpenzimet procedurale/gjyqësore, si dhe tregohet e drejta dhe afati i ankimit për palët. Gjithashtu, tek të pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme. Në çdo rast, vendimet e ndërmjetme jepen me tekst të qartë arsyetimi dhe gjithmonë kanë referuar edhe bazën ligjore.

Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga Gjyqtarja Migena Laska, në 4 raste ka qenë brenda afateve standard apo ligjore dhe në intervale kohore nga 1 muaj e 25 ditë deri në 3 muaj e 8 ditë. Në dy dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 2 muaj e 14 ditë dhe 2 muaj e 16 ditë. Dosja e vetme me kohëzgjatje jashtë afateve standarde, është ajo për gjykimin e ankimit penal kundër vendimit të prokurorisë, në intervalin kohor 4 muaj e 23 ditë, tej afatit standard 2/mujor (shihni dosjen 5). Vlen për t'u theksuar për këtë dosje, se në tri raste është vendosur nga gjykata shtyrja e seancës gjyqësore, për mosparaqitje të organit të prokurorisë. Në dosjet e vëzhguara, është konstatuar se është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor.

Së fundmi, duke konsideruar të dhënat e mësipërme, konstatohet se gjyqtarja Migena Laska ka aftësi të mira për të përballuar ngarkesën në punë, ka pasur ngarkesë sasiore mbi standardin minimal dhe i ka kushtuar rëndësinë e duhur gjykimit dhe arsyetimit të shpejtë të vendimeve gjyqësore.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit Migena Laska ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Gjatë gjykimit, identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre, zhvillon sipas ligjit procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, që nga çelja e seancës, tek parashtrimet e palëve, administrimi i provave, diskutimet përfundimtare dhe deri te shpallja e vendimit.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se ato kanë qenë të rregullta, të sakta dhe të plota. Për veprimet e kryera në seancë gjyqësore është mbajtur procesverbal gjyqësor, bazuar në dispozitat procedurale penale. Në çdo dosje të vëzhguar gjendet vendimi për caktimin e seancës gjyqësore, aktet e përfaqësimit, aktet e njoftimit të palëve, kërkesat me shkrim të tyre dhe provat e paraqitura. Të gjitha procesverbalet gjyqësore të administruara në dosje, rezultojnë se janë të plota me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera, në përputhje me kërkesat e germës “ç”, pika 1, të nenit 345, të Kodit të Procedurës Penale. Të gjitha procesverbalet rezultuan të nënshkruara nga sekretarja gjyqësore dhe gjyqtarja, komfor kërkesave të nenit 345 të Kodit të Procedurës Penale. Procesverbali gjyqësor dokumenton kohën dhe vendin, veprimet që janë kryer në seancë dhe dispozitivin e vendimit në fund të shqyrtimit gjyqësor.

Dosjet janë të inventarizuara rregullisht dhe janë sistemuar në mënyrë kronologjike, në fillim janë vendosur aktet e paraqitura nga palët ndërgjyqëse e më pas aktet procedurale të krijuara nga gjykata, duke pasqyruar kronologji në renditjen e akteve dhe duke u bërë lehtësisht të shfrytëzueshme për palët.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Migena Laska përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Migena Laska dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Migena Laska. Në pesë dosjet e vëzhguara, nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Migena Laska nuk ka respektuar rregullat procedurale me pasojë cenimin e parimit të gjykatës së paanshme.

C/1 RIVLERËSIMI PROFESIONAL

Komisioni, pasi u njoh dhe analizoi të gjithë dokumentacionin e depozituar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor mbi të cilin është hartuar raporti i vlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit, ka konstatuar se:

- Në tri dokumentet e përzgjedhura dhe pesë dosjet e vëzhguara, janë ankimuar 6 prej tyre. Në të gjitha këto raste, Gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit. Në dy rastet e tjera nuk është ushtruar ankimi nga palët.
- Në dispozitivin e vendimit, disponohet për shpenzimet procedurale/gjyqësore, si dhe tregohet e drejta dhe afati i ankimit për palët.
- Në tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve penale ka qenë brenda afateve standard apo ligjore.
- Edhe në pesë dosjet e përzgjedhura me short, përgjithësisht kohëzgjatja e gjykimeve ka qenë brenda afateve standard apo ligjore.
- Në lidhje me etikën dhe angazhimin e subjektit, ndaj vlerave profesionale nga dokumentacioni i administruar për të, nuk u evidentuan problematika.
- ✓ Në konkluzion, trupi gjykues, në analizë të gjetjeve të raportit të rivlerësimit profesional, të dokumentacionit të administruar dhe rivlerësimit të kryer, konkludon se nuk evidentohen apo diktohen rrethana që mund të ndikojnë në aftësitë profesionale të subjektit.

Në lidhje me denoncimet⁴⁵ e paraqitura në Komision për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, për shtatë prej tyre ka rezultuar, si vijon:

⁴⁵ Depozituar në Komision, shtatëmbëdhjetë të tillë. Krahas këtyre janë depozituar edhe dy denoncime përkatësisht, njëri në datën 4.5.2021 dhe tjetri në datën 10.5.2021. Lidhur me këto të fundit, denoncimi i parë është adresuar anonim, ndërsa i radhës është adresuar nga shtetasi E.K. .Të dy denoncimet janë analizuar në procesverbalin e datës 13.05.2021.

1. Denoncim⁴⁶ i shtetasit B. I.

Denoncuesi ankohet ndaj vendimit penal nr. ***, datë 10.04.2014, si alogjik dhe arbitrar, pasi është prishur e kthyer për rigjykim nga Gjykata e Apelit Tiranë, mbi ankimin e ushtruar prej tij. Ankohet ndaj vendimit të dhënë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan ku subjekti i rivlerësimit në këtë rast ka qenë e deleguar nga KLD-ja. Për këtë çështje pretendon se nuk është njoftuar për zhvillimin e gjykimit sipas nenit 139 dhe 333 të Kodit të Procedurës Penale, si një ndër shkeljet më të rënda kushtetuese, se ka caktuar avokat pa e vënë në dijeni dhe se nuk ka shprehur në vendim diskutimin përfundimtar të palëve. Gjithashtu, denoncuesi ka parashtruar edhe shkelje të tjera të pretenduara prej tij kryesisht të natyrës procedurale, duke identifikuar edhe vendimmarrje të tjera të dhëna në kundërshtim me ligjin, sikurse citon vendimin nr. *** akti, datë 9.9.2015, me të cilin është vendosur “shpallja e moskompetencës në shqyrtimin e kërkesës penale me nr. ***akti”. Për këtë të fundit ankohet se subjekti është shprehur me vendim në një kohë që ndaj saj po shqyrtohej kërkesa e bërë prej tij, për përjashtim gjyqtari. Denoncuesi ka depozituar përgjigjen e KLD-së, datë 12.4.2018, me të cilën është njoftuar lidhur me vendimin e marrë për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtares për shkelje të etikës, mbi ankesën e tij për vendimin nr. ***akti, datë 12.12.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe shkresën datë 28.12.2015, për dërgimin e dosjes Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

1.2 Për sa më sipër, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime për sa pretendohet në tërësi nga denoncuesi, por duke u përqendruar kryesisht: (i) te vendimi nr. *** akti, datë 12.12.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për të cilin duhet saktësuar data e regjistrimit të çështjes, pasi nuk pasqyrohet në vendim, fakti nëse ndaj vendimit është ushtruar ankim dhe, më tej, duke vijuar edhe me statusin aktual të çështjes; (ii) te vendimi nr. *** akti, datë 9.9.2015, është vendosur çështja e kompetencës, duke saktësuar datën e regjistrimit të çështjes, ushtrimin e të drejtës ankimore nga pala, si dhe statusin aktual të çështjes; si dhe (iii) te vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që i përket dosjes penale me nr. ***akti, datë 20.10.2015, me objekt “përjashtimi i gjyqtares Migena Laska”.

1.3 Subjekti në prapësimet e saj, ndër të tjera, ka shpjeguar:

- a) Te vendimi i dhënë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, nr. ***akti, datë 12.12.2014, është ushtruar ankim nga kërkuuesi B. I. . Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. ***, datë 20.7.2016, ka vendosur “lënien në fuqi të vendimit nr. ***akti, datë 12.12.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”. Kërkuuesi ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Gjykata e Lartë dhe me vendimin nr. 00-2016 – 2241, datë 15.12.2016, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ka vendosur “mospranimin e rekursit të ankuesit”.

Bashkëngjitur këtij materiali me shkrim subjekti ka depozituar praktikën gjyqësore dërguar me shkresën zyrtare nr. ***prot., datë 28.4.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

- b) Bazuar në vendimin nr. *** akti, datë 10.4.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkuues B. I., me objekt “kundërshtim vendimi prokurori për mosfillim procedimi penal”, është vendosur “pushimi i çështjes”, pasi ka rezultuar që kërkuuesi B.I., i njoftuar proceduralisht, pasi konfirmohej të kishte marrë dijeni, pa asnjë shkak të arsyeshëm dhe pa paraqitur ndonjë kërkesë paraprake, nuk është paraqitur në seancë gjyqësore. Për këtë shkak është pushuar gjykimi. Kundër këtij vendimi është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 18.02.2015 ka vendosur: “Prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues”.
- c) Me vendimin Nr. *** akti, dt. 09.09.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur “shpallja e moskompetencës (tokësore) në shqyrtimin e kësaj kërkesë penale

⁴⁶ Nr. *** prot., datë 13.12.2017 dhe nr. *** prot., datë 23.9.2018.

me nr. *** akti. Dërgimin e akteve të paraqitura përpara kësaj gjykate, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila është kompetente në shqyrtimin e kësaj kërkesë”.

Lidhur me këtë vendim në zbatim të nenit 85 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, nuk parashikohet “instrument ankimimi” nga pala (sa i përket shpalljes së moskompetencës tokësore). Në nenin 90 të Kodit të Procedurës Penale ligjvënësi ka parashikuar: “*Mosmarrëveshjet për moskompetenca*”. Gjykata që ngre çështjen e mosmarrëveshjes, merr vendim, me të cilin i paraqet Gjykatës së Lartë kopjen e akteve të nevojshme për zgjidhjen e saj, duke treguar palët dhe mbrojtësit (shihni nenin 90/2 Kodit të Procedurës Penale).

Neni 91 i Kodit të Procedurës Penale, parashikon: “*Zgjidhja e Mosmarrëveshjes. Mosmarrëveshjet zgjidhen nga Gjykata e Lartë, me vendim. Gjykata merr të dhënat, aktet dhe dokumentet që i çmon të nevojshme*”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, pranë të cilës kanë kaluar për shqyrtim gjyqësor aktet, nuk rezulton të ketë shpallur konflikt kompetence në Gjykatën e Lartë, sipas nenit 90 – 91 të Kodit të Procedurës Penale. Rrjedhimisht, kjo çështje ka vijuar të gjykohej normalisht komfor dispozitive ligjore të Kodit të Procedurës Penale, gjykimin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

- d) Te vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që i përket dosjes penale me nr. *** akti, datë 20.10.2015, me objekt “përrjashtimi i gjyqtarës Migena Laska”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** akti, datë 20.5.2015, me kërkesë B.I., ka vendosur “pushimin e gjykimit të kërkesës penale me kërkesë B. I.”, pasi ka rezultuar se kërkesi B. I. nuk është paraqitur në gjykim, pa shkaqe të arsyeshme. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila ka vendosur “prishjen e vendimit nr. ***, datë 20.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e akteve në po atë gjykatë, me një tjetër trup gjykues”.

Subjekti, për sa më sipër, ka shpjeguar, si dhe ka depozituar edhe vendimet gjyqësore.

1.4 Në tërësi, në analizë të shpjegimeve dhe dokumentacionit të administruar, trupi gjykues vëren se subjekti ka sqaruar dhe argumentuar ligjërisht ecurinë e proceseve gjyqësore, si dhe ka ndërmarrë hapat e duhur proceduralë në përmbushjen e detyrës së saj. Në të tilla kushte nuk vërehen problematika në lidhje me këtë çështje të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional.

2. Denoncim⁴⁷ i shtetasit B.K.

2.1 Denoncuesi ankohet për vendimmarrje të padrejtë dhënë ndaj tij dhe djalit. Denoncuesi ka depozituar vendimin gjyqësor nr. ***, datë 3.6.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të pandehur denoncuesin dhe djalin e tij, të akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 89 dhe 88/1 – 25 të Kodit Penal “plagosje e lehtë me dashje” dhe “plagosje e rëndë me dashje”. Nga verifikimi i vendimit vërehet se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar në cilësinë e kryesueses së çështjes. Nuk pasqyrohet mbi marrjen ose jo të formës së prerë të vendimit.

2.2 Për sa më sipër, subjektit i është kërkuar të qartësojë mbi statusin aktual të kësaj vendimmarrjeje, si dhe të depozitojë dokumentacionin mbështetës.

2.3 Subjekti, ndër të tjera, në shpjegime ka qartësuar se vendimi nr. ***, datë 3.6.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është ankimuar dhe me vendimin nr. ***, datë 27.5.2015, Gjykata e Apelit Tiranë, pasi e ka shqyrtuar ankimin, ka vendosur “lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 27.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. 00-2016-2137, datë 9.12.2016, ka vendosur “*mospranimin e rekursit*”.

⁴⁷Denoncim nr. ***prot., datë 12.2.2018.

2.4 Subjekti ka depozituar vendimet gjyqësore, të nxjerra nga sistemi i brendshëm i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2.5 Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të denoncuesit, të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe të dokumentacionit të depozituar prej tij, nuk konstatoi problematika të natyrës procedurale. Vërehet se subjekti ka ndjekur të gjitha hapat proceduralë dhe ligjorë në veprimet gjyqësore të ndërmarra për gjykimin e çështjes. Nga ana tjetër, trupi gjykues nuk ka tagrin të reflektojë apo argumentojë situatën gjyqësore, lidhur me themelin e çështjes dhe as të zëvendësojë logjikën e gjyqtarit në arsyetimin e vendimit, për më tepër, kur rezultoi që çështja është shqyrtuar dhe ka përfunduar në të gjitha shkallët e gjykimit.

3. Denoncim⁴⁸ i shtetasit H. Xh.

3.1 Denoncuesi në ankimin e tij denoncon subjektin e rivlerësimit për proces jo të rregullt ligjor, duke mos marrë në konsideratë provat që sipas tij vërtetojnë të drejtën e tij. Denoncuesi nuk jep të dhëna të tjera referuese dhe as nuk ka depozituar dokumentacion që të mund të verifikohet dhe konkludohet.

3.2 Për sa më sipër, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime lidhur me pretendimin e denoncuesit, duke u përqendruar kryesisht te statusi aktual i çështjes, si dhe të depozitojë dokumentacionin mbështetës.

3.3 Subjekti në prapësime ka sqaruar se me vendimin nr. ***, datë 14.11.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka disponuar me vendim përfundimtar, lidhur me çështjen civile me palë të paditur H. Xh., me objekt “pjesëtim i sendit në bashkëpronësi”, faza e dytë e gjykimit, pasi kishte marrë formë të prerë gjykimi i çështjes lidhur me fazën e parë të pjesëtimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në fazën e dytë të gjykimit për “pjesëtimin e sendit”, bazohet në dokumentacionin, i cili rezulton i administruar në fashikullin gjyqësor, që lidhet me gjykimin e fazës së parë të pjesëtimit gjyqësor. Provat shkresore dhe pjesët (ideale) takuese të pjesëtimit të pasurisë në bashkëpronësi përcaktohen, pikërisht, në gjykimin e fazës së parë. Gjykimi i fazës së parë për këtë çështje civile, rezulton të jetë shqyrtuar deri me shqyrtimin e rekursit në Gjykatën e Lartë. Më pas, kjo çështje ka mbërritur për gjykim te gjyqtare Migena Laska, vetëm pasi janë shteruar të gjitha mjetet e ankimit lidhur me gjykimin e fazës së parë, pra, pasi faza e parë e pjesëtimit të pasurisë në bashkëpronësi, kishte marrë formë të prerë dhe rrjedhimisht, pretendimet e shtetasit H. Xh., nuk qëndrojnë. Kundër këtij vendimi rezulton të jetë ushtruar ankim dhe çështja aktualisht ndodhet për shqyrtim themeli në Gjykatën e Apelit Tiranë. Subjekti ka depozituar kopjen e vendimit gjyqësor.

3.4 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna, por edhe nga verifikimi i dokumentacionit, nuk konstatoi problematika të natyrës procedurale. Për sa i përket themelit të çështjes në koherencë me pretendimin e denoncuesit, se nuk janë marrë në konsideratë provat që sipas tij vërtetojnë të drejtën e tij, lehtësisht kuptohet që në rastin e një objekti gjyqësor pjesëtim pasurie, për sa kohë palët nuk e zgjidhin atë me vullnet mes tyre, çështja i nënshtrohet rrugës gjyqësore dhe se për sa kohë faza e parë e pjesëtimit (në pjesë ideale) përfundon, pra, vendimi ka marrë formë të prerë, atëherë vijueshmëria e fazës së dytë është rrjedhojë e fazës së parë, ku thjesht dhe vetëm palët me vendimmarrje përfitojnë pjesën në natyrë apo në të holla dhe, për pasojë, mendohet dhe vlerësohet se ato kanë depozituar çdo provë të mundshme në fazën e parë të pjesëtimit, për ta bërë shterues gjykimin e kësaj faze nga e cila derivojnë edhe pasojat finale. Vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit është atribut i gjyqtarit dhe jo tagër i Komisionit, aq më tepër në kushtet kur aktualisht çështja ndodhet në shqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

4. Denoncim⁴⁹ i shtetasit R.T.

4.1 Denoncuesi ankohet për mungesë profesionalizmi të subjektit të rivlerësimit, për shkak se prej saj i është vendosur gjobë pa e njoftuar lidhur me mangësi të dokumentacionit. Denoncuesi

⁴⁸ Nr. *** prot, viti 2018.

⁴⁹Denoncim nr. *** prot., datë 7.11.2018.

nuk ka sqaruar lidhur me ecurinë e procesit gjyqësor, lidhur me statusin e çështjes dhe as ka depozituar ndonjë dokumentacion mbështetës të pretendimeve të tij.

4.2 Për sa më sipër, subjekti i është kërkuar të japë shpjegime duke u përqendruar te pretendimi i denoncuesit, të depozitohet vendimin përkatës të këtij procesi gjyqësor, si dhe të qartësojë mbi statusin aktual të tij (gjithnjë nëse është ankimuar).

4.3 Subjekti në shpjegimet e dhëna ka qartësuar mbi vendimmarrjet e marra dhe ushtrimin e të drejtës ankimore nga palët. Më konkretisht ka konfirmuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr. ***, datë 20.9.2018, me paditës R.T., ka vendosur “kthimin e kërkesë padisë nr. ***akti, palës paditëse”. Kundër këtij vendimi gjyqësor, paditësi R.T., nuk ka ushtruar ankim, pra, vendimi ka marrë formë të prerë. Në datën 19.10.2018, është regjistruar kërkesë padia me paditës R. T., me të njëjtat palë ndërgjyqëse, me të njëjtin objekt padie, bazë ligjore, shkak ligjor, si dhe bazuar në të njëjtin dokumentacion shoqërues. Gjykata ka konstatuar se kjo padi ka qenë e përsëritur, krejtësisht njësoj si e tillë, prandaj bazuar në vendimin nr. ***, datë 30.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në zbatim të neneve 154, 154/a dhe 34 të Kodit të Procedurës Civile ka vendosur “Kthimin e kërkesë padisë nr. 13861 akti, të paditësit R. T. . Gjobitjen e paditësit me 100.000 lekë të reja gjobë.” Kundër këtij vendimi rezultoi të jetë ushtruar ankim nga paditësi R. T. . Kjo çështje aktualisht ndodhet për shqyrtim gjyqësor në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe pretendimet e ngritura nga shtetasi R. T., bazuar në faktet dhe në rrethanat konkrete nuk qëndrojnë. Shtetasi R.T., është komunikuar dhe njoftuar me vendimin nr. ***, datë 20.9.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin i janë kthyer aktet e padisë së tij, bazuar në shkaqet e arsyetuara nga gjykata në atë vendim. Ndonëse ka kaluar afati ligjor procedural, paditësi nuk ka ushtruar ankim. Në këtë mënyrë, vendimi ka marrë formë të prerë. Paçka nga kjo, paditësi më pas ka paraqitur të njëjtën kërkesë padi, në të njëjtat kushte dhe rrethana, në të cilat gjykata kishte proceduar më parë me “kthimin e akteve”. Kjo ka qenë dhe arsyeja, pse gjykata në zbatim rigoroz me nenet 154, 154/a dhe 34, të Kodit të Procedurës Civile ka vendosur “Kthimin e kërkesë padisë nr***akti, të paditësit R. T.; Gjobitjen e paditësit me 100.000 lekë...”. Subjekti ka depozituar kopje të vendimeve gjyqësore të sipërcituara të nxjerra nga sistemi i brendshëm i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4.4 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna dhe dokumentacionit të depozituar, vëren se qëndrojnë argumentet e paraqitura nga subjekti lidhur me veprimet e ndërmarra në gjykimin e kësaj çështje, të cilat janë finalizuar me vendimmarrjet përkatëse. Në tërësi, nuk vërehet ndonjë rrethanë konkrete në të cilën gjyqtari/subjekti i rivlerësimi të ketë shkelur normat procedurale, etikën apo solemnitetin e procesit.

5. Denoncim⁵⁰ i përfaqësuesit ligjor N. Gj.

5.1 Denoncuesi si përfaqësues ligjor me prokurë, për disa palë në një çështje civile, ankohet për disa⁵¹ çështje të regjistruara të cilat sipas tij po gjykohen nga subjekti i rivlerësimi dhe se gjyqtarja ka disponuar me kthim aktesh pa asnjë shkak ligjor duke cenuar rëndë imazhin e saj. Denoncuesi pretendon se subjekti me veprimet dhe mosveprimet e saj, në shkelje flagrante të ligjit dhe etikës së gjyqtarit, ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykim të palëve që përfaqëson, ka cenuar procesin e rregullt ligjor për një gjykim, brenda afatit të arsyeshëm dhe, për pasojë, ka dëmtuar interesat e palëve.

Nga verifikimi i vendimeve gjyqësore të vëna në dispozicion nga denoncuesi, vërehet se ky i fundit me cilësinë e përfaqësuesit të palës paditëse i është drejtuar gjykatës tri herë me të njëjtën padi për shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror, etj., nga palë të paditura, kompani sigurimesh, për shkak të aksidenteve të pësura në dëm të paditësve. Nga leximi i vendimeve, pa zëvendësuar logjikën e gjyqtarit, konstatohet se padia është kthyer me të meta të konstatuara prej depozitimit për herë të parë dhe se po e njëjta padi me të njëjtat palë ndërgjyqëse, objekt e

⁵⁰Denoncim nr. *** prot., datë 1.4.2019.

⁵¹Vendimet: nr***, datë 12.12.2017; nr. ***, datë 7.11.2018; nr. ***, datë 26.11.2018; nr. ***, datë 24.1.2019; si dhe nr. ***, datë 28.3.2018.

bazë ligjore është depozituar edhe dy herë të tjera duke u dhënë i njëjti dispozitiv nga e njëjta gjyqtare, konkretisht nga subjekti i rivlerësimit. Njëkohësisht denoncuesi sikurse edhe vetë ka pranuar në shpjegimet e tij se fillimisht nuk ka ushtruar ankim ndaj kthimit të padisë me të meta, edhe gjykata e ka cilësuar këtë fakt në kthimin e përsëritur të padisë. Në kushte të tilla, në këtë rast, për sa kohë denoncuesi nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit, por ka vijuar në mënyrë të përsëritur të adresojë të njëjtën padi, çdo vlerësim ndryshe nga Komisioni lidhur me vendimmarrjet e subjektit, do të ishte në tejkalim të kompetencave lidhur me vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit. Ndërsa, Komisioni ka kërkuar⁵² kopje të dosjes gjyqësore që i përket vendimit nr. ***, datë 28.3.2018, me të cilin është vendosur “pushimi i gjykimit” (edhe kjo çështje e pretenduar nga denoncuesi), me palë ndërgjyqëse, paditës V. Gj. dhe të paditur shoqëria e sigurimeve “****” sh.a. Nga administrimi⁵³ i akteve dhe njohja me to, është konstatuar se pala e paditur (administrator i saj) ka kërkuar në datën 1.2.2018 shtyrje të seancës së lënë po në këtë datë dhe po ashtu ka kërkuar (përfaqësuesja e saj) edhe në datën 27.2.2018 shtyrje të seancës së lënë po në këtë datë, kërkesë e cila është rrëzuar duke u arsyetuar, ndër të tjera, si e përsëritur. E njëjta kërkesë është depozituar edhe nga përfaqësuesi i palës paditëse në datën 28.3.2018, për seancën e lënë po në këtë datë, mungesa e të cilit ka passjellë pushimin e gjykimit të çështjes.

5.2 Subjektit i është kërkuar që të qartësojë nëse lidhur me këtë çështje është ushtruar e drejta e ankimit nga palët dhe në varësi të kësaj të fundit të qartësojë mbi statusin aktual të saj.

5.3 Subjekti në prapësime, ka sqaruar se pretendimet e denoncuesit janë të padrejta, të pavërteta, të pasakta, të pabazuara në prova, në fakte dhe në ligj. Subjekti, ndër të tjera, ka sqaruar si vijon:

- a) Me vendimin nr. ***akti, datë 13.10.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me kërkesë padinë civile të paraqitur nga paditësi V. Gj., ka vendosur “konstatimin e të metave të kërkesë padisë. Plotësimin e të metave të konstatuara, deri në datën 21.12.2017, ora 11:30”. Në seancën e datës 20.12.2017, paditësi ka paraqitur një kërkesë për saktësimin e objektin e padisë, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata. Gjykata në këtë seancë ka vendosur “kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore, duke vijuar normalisht me procesin gjyqësor në seancë gjyqësore”. Më pas, në seancën e datës 28.0.2018, ora 11:09, ka rezultuar se paditësi dhe mbrojtësi i tij nuk ishin paraqitur. Avokati kishte paraqitur kërkesë për shtyrje seance me pretendimin se ndodhej në një gjykim tjetër. Pala e paditur në gjykim, ka kërkuar pushimin e gjykimit. Ekspertët të pranishëm në seancë kanë deklaruar se ndonëse akti i ekspertimit ishte kryer prej tyre, pala paditëse dhe avokati mbrojtës i tij, nuk pranonin që t’i takonin për të përmbushur detyrimet ligjore sa i takon faturës tatimore, në favor të ekspertëve. Gjykata, e ka gjetur kërkesën e avokatit të pabazuar në ligj, në kushtet kur seanca ishte caktuar në prani dhe në marrëveshje të plotë të palëve ndërgjyqëse, përfshirë edhe avokatin N. Gj., si dhe bazuar në nenet 179 dhe 299/c të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur “pushimin e gjykimit të çështjes civile me nr. *** akti”. Ky vendim nuk është ankimuar nga asnjë palë ndërgjyqëse. Rrjedhimisht, ky është një vendim i formës së prerë. Më pas, në datën 24.5.2018, është regjistruar sërish çështja civile me palë paditës V. Gj., i paditur shoqëria e sigurimeve “****” sh.a. Gjykata, pasi ka kryer gjithë shqyrtimin gjyqësor lidhur me këtë çështje, në përfundim, bazuar në argumentet ligjore të evidentuara në vendimin e arsyetuar të saj, bazuar në fakte, në prova dhe në ligj, ka vendosur “pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë të paditësit...”. Ky vendim është i ankimuar dhe aktualisht është për gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë.
- b) Me vendimin nr. *** akti, datë 19.2.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me kërkesë padinë civile të paraqitur nga paditësi V.C. etj., ka vendosur “konstatimin e të metave të kërkesë padisë. Plotësimin e të metave të konstatuara, deri në datën 26.3.2019, ora 11:00”. Me vendimin nr. ***, datë 26.3.2019, gjykata në kushtet kur

⁵²Me shkresën nr. ***prot., datë 7.4.2021.

⁵³Me shkresën përcjellëse nr. ***prot., datë 23.4.2021.

pala paditëse pa shkaqe të arsyeshme nuk kishte plotësuar të metat e konstatuara në mënyrë eksplicite nga gjykata, bazuar në nenet 154 dhe 154/a të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur “kthimin e kërkesë padisë me nr. ***akti.” Ky vendim rezultoi i formës së prerë, pasi ndaj tij nuk është ushtruar nga askush ankimi.

- c) Me vendimin nr***, datë 12.12.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me kërkesë padinë civile të paraqitur nga paditësi Gj. M., etj, bazuar në nenet 154, dhe 154/a të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur “kthimin e kërkesë padisë me nr. ***akti.” Ky vendim rezultoi i formës së prerë, pasi ndaj tij nuk është ushtruar nga askush ankimi.
- d) Me vendimin nr. ***, datë 7.11.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me kërkesë padinë civile të paraqitur nga paditësi Gj. M., etj., bazuar në nene 154 dhe 154/a të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur “kthimin e kërkesë padisë me nr. *** akti”. Ky vendim rezultoi i formës së prerë, pasi ndaj tij nuk është ushtruar nga askush ankimi.
- e) Me vendimin nr. ***, datë 26.11.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me kërkesë padinë civile të paraqitur nga paditësi Gj.M., etj., bazuar në nenet 154, 154/a të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur “kthimin e kërkesë padisë me nr. *** akti”. Ky vendim rezultoi i formës së prerë, pasi ndaj tij nuk është ushtruar nga askush ankimi.
- f) Në datën 19.12.2018, është regjistruar sërish e njëjta kërkesë padi me paditës Gj.M., etj., të mbrojtur e të përfaqësuar po nga avokati N. Gj. . Padia, ka rezultuar krejtësisht e njëjtë dhe e paraqitur në të njëjtat kushte dhe në të njëjtën gjendje faktike, si për kërkimet ashtu edhe për dokumentacionin shoqëruar. Në cilësinë e gjyqtarës (me qëllimin e vetëm), jo vetëm për të qenë, por edhe për t’u dukur krejtësisht e paanshme dhe pa asnjë lloj ngarkese personale, në gjykimin dhe në administrimin e kësaj çështje civile, kam paraqitur para Kryetarit të Gjykatës ë Rrethit Gjyqësor Tiranë, “dorëheqjen time”, në zbatim të nenit 73 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo dorëheqje, nuk është pranuar nga Kryetari i Gjykatës ë Rrethit Gjyqësor Tiranë. Rrjedhimisht, ka vijuar krejt normalisht gjykimin e kësaj çështje civile. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** , datë 24.1.2019, lidhur me kërkesë padinë civile të paraqitur nga paditësi Gj.M., etj, bazuar në nenet 154, 154/a dhe 34 të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur “kthimin e kërkesë padisë nr. ***akti. Gjjobitjen e palës paditëse me 100.000 lekë të reja”. Ky vendim rezultoi të jetë ankimuar dhe aktualisht ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

5.4 Subjekti ka depozituar vendimet gjyqësore, si dhe kopjen e procesverbalit, nxjerrë nga sistemi i brendshëm i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5.5 Për sa më sipër, trupi gjykues vëren se subjekti ka sqaruar në detaje ecurinë e proceseve gjyqësore, veprimet procedurale të ndërmarra në gjykim, pjesëmarrjen e palëve ndërgjyqëse në gjykim, por edhe arsyet ligjore të kthimit të padive, etj. Trupi gjykues nuk konstatoi problematika të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit, duke konsideruar këtu edhe faktin se dy prej çështjeve rezultojnë të jenë ende në gjykim për shkak të ankimit të ushtruar dhe ku ligjërimi i vendimmarrjeve është kompetencë e gjykatës së shkallës më të lartë.

6. Denoncim⁵⁴ i shtetasit A. P.

6.1 Denoncuesi ankohet për vendimmarrje të padrejtë të dhënë ndaj tij, nga subjekti i rivlerësimit. Ndër të tjera, ankohet se në padi kishte kërkuar edhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit, ndërsa kjo kërkesë nga subjekti nuk ishte përmendur në vendim, pa dhënë ndonjë arsye. Gjithashtu, ankohet se nuk i është lënë nga përmbartuesi gjyqësor afati 10-ditor i njoftimit, përpara se të nxirrte pronat në shitje, sipas nenit 567 të Kodit të Procedurës Civile. Denoncuesi ka depozituar vendimin gjyqësor nr. *** , datë 23.12.2019, të Gjykatës së Rrethit

⁵⁴Denoncim nr. *** prot., datë 30.1.2020.

Gjyqësor Tiranë, si dhe kërkesën ankimore drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 20.11.2019. Denoncuesi nuk ka sqaruar nëse e ka ushtruar të drejtën e ankimit të veçantë.

Nga verifikimi i dokumentacionit, konstatohet se në vendimin gjyqësor janë identifikuar qartazi palët ndërgjyqëse, objekti i ankimit përfshirë edhe kërkitimi i pezullimit të ekzekutimit të vendimit nr. ***, datë 16.6.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apel dhe, për pasojë, kthyer në titull ekzekutiv, si dhe dispozitivi ku pasqyrohet “mospranimi i ankimit të denoncuesit”.

6.2 Për sa më sipër, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime duke u përqendruar te pretendimi i denoncuesit se nga përmbaruesi gjyqësor nuk është zbatuar neni 567 i Kodit të Procedurës Civile, të depozitohet edhe dokumentacionin mbështetës nga praktika gjyqësore, pas së cilës është rezultuar në vendimmarrje, si dhe të qartësojë lidhur me statusin aktual të kësaj çështje.

6.3 Subjekti në prapësime ka qartësuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 23.12.2019, ka shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga ankuesi A.P., me objekt “pezullimin e urdhrin të ekzekutimit vendimi nr. ***akti, datë 16.6.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, marrë formë të prerë me vendimin nr****, datë 11.6.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Anulimin e vendimit nr. ***, datë 18.11.2019, për shpalljen e ankandit të parë të pasurisë debitore, me bazë ligjore nenet 610 – 567 të Kodit të Procedurës Civile dhe, më tej, ka sqaruar se:

Bazuar në vendimin e arsyetuar në 6 faqe, nr. ***, datë 23.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në zbatim të neneve 567-610 të Kodit të Procedurës Civile, është vendosur “mospranimi i ankimit të paraqitur si i pambështetur në prova dhe në ligj”.

Në zbatim të nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata ka shqyrtuar këtë ankim brenda afatit ligjor dhe në kushtet kur kërkesa ka rezultuar e pambështetur në prova dhe në ligj, ka disponuar për mospranimin e ankimit – neni 610 i Kodit të Procedurës Penale “Kundërshtimi i veprimeve të përmbaruesit gjyqësor”. Ndër të tjera, në këtë dispozitë ligjore, parashikohet: *“Ankimi kundër veprimeve apo refuzimit të përmbaruesit gjyqësor, nuk pezullon ekzekutimin, përveç kur gjykata vendos ndryshe”*.

Gjykata në rastin konkret, bazuar në faktet, në provat, në argumentet e sqaruara konkretisht në arsyetimin ligjor të këtij vendimi, ka disponuar duke mos e pranuar në tërësi këtë ankim – neni 610 i Kodit të Procedurës Civile. Rrjedhimisht, nuk ka pasur asnjë shkak ligjor për të disponuar në veçanti, për “Pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv”, sa kohë që nuk ka gjetur asnjë shkak ligjor për këtë. Kundër këtij vendimi gjyqësor, rezulton të jetë ushtruar ankim. Çështja aktualisht ndodhet për shqyrtim gjyqësor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

6.4 Subjekti ka depozituar kopje të vendimit gjyqësor të arsyetuar me nr. ***, datë 23.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6.5 Trupi gjykues, në analizë të argumenteve ligjor të paraqitura nga subjekti në parashtrimet e saj lidhur me gjykimin e kësaj çështjeje, nuk vëren ndonjë rrethanë konkrete në të cilën gjyqtari/subjekti i rivlerësimit të ketë shkelur normat procedurale. Nga ana tjetër, trupi gjykues vlerëson se nuk ka kompetencë të gjykojë mbi themelin e çështjes, për sa kohë ajo mund të jetë në proces gjyqësor, për shkak të ankimit të ushtruar dhe ku ligjërimi i vendimmarrjes është kompetencë e gjykatës së shkallës më të lartë.

7. Denoncim⁵⁵ i shtetasit R. Sh.

7.1 Denoncuesi në ankimin e tij pretendon për njëanshmëri të subjektit të rivlerësimit në vendimmarrjen e çështjes me nr. *** akti, datë 3.6.2020, me të cilën është pranuar kërkesa e prokurorit për pushimin e çështjes penale nr. ***, në kundërshtim me ligjin duke shkelur të drejtat e tij për një proces të rregullt ligjor. Denoncuesi ankohet se gjyqtarja në vendimin e saj nuk ka arsyetuar dhe nuk u ka dhënë përgjigje kërkesave të paraqitura prej tij në cilësinë e viktimës në gjykim, por thjesht dhe vetëm ka kopjuar kërkesën e prokurorit të çështjes.

⁵⁵Denoncim nr. *** prot., datë 18.6.2020.

Gjithashtu, ankohet se edhe pse seanca është mbajtur në sallë nuk disponohet audio për provueshmërinë e së cilës sqaron se ka paraqitur edhe kërkesë për të pasur një kopje të saj.

Në lidhje me rrethanat e çështjes, denoncuesi ka referuar se pushimi i kërkuar nga organi i akuzës i përket kallëzimit të bërë nga denoncuesi në adresë të dy notereve (nënë e bijë), për të cilat pretendon se kanë falsifikuar dokumentet duke shpërdoruar detyrën e tyre funksionale. Më konkretisht, ka pretenduar se është falsifikuar nënshkrimi i një testamenti të lëshuar nga babai i tij, akt i pa hedhur në RNSH nga noterja, në kohën e hartimit, etj. Denoncuesi sqaron se nuk është mbajtur në vëmendje nga organi i akuzës akti i ekspertimit në të cilin thuhet se shkrimi i aktit mund të jetë bërë nga testatori, ndërsa për nënshkrimin e aktit nuk mund të konkludohet. Po ashtu, sqaron se edhe gjykata është shprehur sikurse ka cituar organi i akuzës se nuk përjashtohet mundësia të jetë shkruar e nënshkruar nga testatori, ndërsa shprehet ai në fakt aktekspertimi ka qenë i ndarë në konkluzione për këto dy momente.

Denoncuesi ka depozituar: kopje të vendimit të prokurorit; kopje të vendimit të gjykatës, dhënë nga subjekti i rivlerësimit në datë 3.06.2020; kopje të ekspertimit grafik; kopje të ekspertimit psikiatriko – ligjor; si dhe një ankim drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ).

Nga aktet rezultoi se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkesën e datës 10.3.2020, i ka kërkuar gjykatës pushimin e çështjes penale nr. ***, datë 25.11.2019, për veprën penale “shpërdorim të detyrës dhe falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga nenet 248 e 186 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetaseve V. dhe V. K. me detyrë noter publik.

a. Nga verifikimi i akteve (*pa zëvendësuar logjikën e gjyqtarit*), ndër të tjera, vërehet se në vendimmarrje në pjesën arsyetuese citohet mbi një aktekspertim, i cili nuk kuptohet se nga cila palë është vendosur në dispozicion të gjykatës, ndërsa kuptohet sikur akti është pjesë e një çështje gjyqësore për pavlefshmëri testamenti, çështje e cila thuhet (po në pjesën arsyetuese të vendimit) se është ende në shqyrtim, pra, e papërfunduar.

b. Gjithashtu, gjykata po në pjesën arsyetuese të vendimit citon edhe konkluzionin e aktit të ekspertimit grafik nr. ***, datë 28.2.2020, i cituar nga organi i akuzës në kërkesën për pushimin e çështjes, konkluzion i cili lehtësisht vërehet se nuk është i njëjtë me atë të përcaktuar nga eksperti në aktin e ekspertimit. Duket se nga gjykata, në vlerësimin e përfundimit të çështjes, nuk është verifikuar konkluzioni i cituar nga eksperti, por është marrë i mirëqenë në vendimmarrje sikurse është cituar nga prokurori i çështjes.

7.2 Për sa më sipër, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime duke u përqendruar te konstatimet e Komisionit në germën “a” dhe “b”, si dhe të qartësojë mbi statusin aktual të kësaj çështje. Gjithashtu, subjektit i është kërkuar të depozitojë çdo dokumentacion të vlerësuar, në mbështetje të shpjegimeve.

7.3 Subjekti në prapësime ka dhënë shpjegime të hollësishme për të provuar se pretendimet e denoncuesit janë të pambështetura si në prova ashtu edhe në ligj. Subjekti ka sqaruar mbi kërkesën penale, me objekt “pushimin e çështjes penale”, në zbatim të neneve 328 dhe 329/a/b të Kodit të Procedurës Penale, me nr. ***Akti, datë 28.4.2020, regjistrimi dhe shqyrtimin e saj nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila në përfundim ka disponuar me vendimin e saj të arsyetuar në 12 faqe, të datës 3.6.2020. Po ashtu, ka trajtuar në mënyrë kronologjike ecurinë e seancave nga ajo paraprake dhe në vijim, për praninë e të gjitha palëve ndërgjyqëse, të cilat sipas radhës procedurale, kanë marrë të drejtën e fjalës në seancë, dhe kanë parashtruar përpara gjykatës të gjitha shpjegimet, prapësimet dhe qëndrimet e tyre. Subjekti ka sqaruar mbi kryerjen e aktekspertimit dhe konkluzionet e dhëna, duke shpjeguar se nuk ka rezultuar asnjë mospërputhje apo pasaktësi, ndërmjet përmbajtjes të këtyre akteve të ekspertimit dhe referimit që gjykata u ka bërë atyre në vendimmarrjen e saj. Asnjë fakt (është shprehur subjekti) apo rrethanë nuk rezulton ndryshe nga sa gjykata ka marrë në analizën e saj juridike në vendimin e arsyetuar në 12 faqe, të datës 3.6.2020. Subjekti qartëson se ka kryer një proces të rregullt ligjor, brenda një afati tepër të arsyeshëm, bazuar në shqyrtimin e plotë, të drejtë, objektiv, të paanshëm të të gjitha provave, fakteve, pretendimeve, prapësimeve, të paraqitura nga secila prej palëve ndërgjyqëse dhe mbështetur në arsyetimin ligjor të bërë në këtë vendim gjyqësor

prej 12 faqe, ka disponuar me vendim përfundimtar, në përputhje me bindjen e saj të brendshme të mbështetur në prova dhe në ligj. Gjithashtu, deri në këtë moment nuk është komunikuar zyrtarisht, asnjë fakt lidhur me ndonjë ankim të paraqitur ndaj subjektit të rivlerësimit, nga shtetasi R. Sh., si në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë, ashtu edhe në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

7.4 Subjekti ka depozituar, vendimin gjyqësor të arsyetuar nr. ***, datë 3.6.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; procesverbalin e seancës paraprake, datë 3.6.2020; vendimin e kalimit të çështjes në seancë paraprake, datë 7.5.2020; si dhe vërtetimin e nxjerrë nga sistemi i brendshëm i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me regjistrimin e kërkesë padisë civile sa i takon çështjes civile të sipër cituar me nr. *** akti, datë depozitimi 17.4.2018 dhe datë regjistrimi 18.4.2018.

7.5 Trupi gjykues, i njohur me të gjitha shpjegimet dhe sqarimet e detajuara të dhëna me shkrim nga subjekti i rivlerësimit, referuar edhe shqyrtimit të dokumentacionit ligjor mbështetës, vlerëson se subjekti ka argumentuar ligjërisht veprimet e ndërmarra në këtë proces gjyqësor dhe se në tërësi nuk konstaton rrethana në të cilën gjyqtari/subjekti i rivlerësimit të ketë shkelur normat procedurale. Trupi gjykues nuk mund të analizojë mbi themelin e çështjes për sa kohë palëve i jepet e drejta e ushtrimit të ankimit dhe paralelisht me të, është gjykata e shkallës më të lartë që ligjëron vendimmarrjen.

Për sa u arsyetua më sipër, Komisioni, pas analizimit të denoncimeve, referuar nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vlerësuar se në tërësi ato nuk përmbajnë fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.

Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016 dhe për këtë shkak konsiderohet “i aftë”.

Vlerësimi i çështjes në tërësi nga trupi gjykues

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara prej saj, çmon se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e saj nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.
- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në

bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti plotëson kushtet e nenit 59/1,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Migena Laska, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 20.5.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI
Kryesuese

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta